

Çfarë i obligohet fillimisht
MUSLIMANIT
të dije prej fesë

Mblodhi dhe përshtati:
FAIK ASANI





Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit.

Hyrje

-Falënderimi i takon vetëm Allahut subhanehu ue te'ala, paqja mëshira dhe bekimi qoftë mbi të Dërguarin tonë Muhammedin sal-lallahu alejhi ue sel-lem

Falenderimet dhe lavdërimet i takojn Allahut te'ala ndërsa selamet dhe salatet qofshin mbi Muhamedin alejhi selam, mbi shokët e tij mbi familjen e tij dhe mbi gjithë ata të cilët pasojnë rrugën e tij deri në ditën e gjykimit.

Allahu Te'ala thotë: **'O ju që besuat, kini frikë All-llahun me sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni, pos vetëm duke qenë muslimanë (besimtarë)!'**

[Ali-Imran: 102]

'O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burrra shumë e gra. Dhe kini frikë All-llahun që me emrin e Tij përбетoheni, ruajeni farefisnin (akraballëkun), se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju.'

[En-Nisa: 1]

'O ju besimtarë, pëmbajuni mësimëve të All-llahut dhe thuani fjalë të drejta. Ai (All-llahu) iu mundëson të bëni vepra të mira, ju shlyen juve mëkatet tuaja, e kush respekton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ai ka arritur një sukses të madh.' [Ahzab: 70, 71]

-Ky libër që gjindet në duart e juaja është një pikënisje dhe një lehtësim për mësimin apo njohjen e disa çështjeve shumë të rëndësishme, që i obligohet çdo njeriut i cili konsideron vetën e tij për musliman, duke ia rikujtuar se ai fillimisht duhet të njohë dhe të mësoj çështjet e Teuhidit (Njëshmëris) dhe çfarë e prish atë, të Imanit (Besimit) dhe çfarë e prish atë, të Ibadetit (Adhurimit) dhe çfarë e prish atë, e që jam munduar që ta bëj në mënyrën më

të thjesht, dhe më të kapshëm për lexuesin.

Dhe këtë libër e kamë ndarë në tri kaptina edhe atë siç vijonë:

- **Kaptina e parë:** Teuhidi me llojet e saja, dhe çfarë e prish atë (Shirku).
- **Kaptina e dytë:** Imani me kushtet e saja, dhe çfarë e mohon atë (Kufri).
- **Kaptina e tretë:** Ibadeti me llojet e saja, dhe çfarë e prishë atë (Er-Rija'u).

- **Kaptina e parë: Teuhidi dhe çfarë e prish atë (Shirku)**

Së pari i obligohet njeriut të dijë; Njohjen e Allahut pastaj të fesë dhe të Dërguarit të Tij, dhe gjëja e parë që e ka begatu Allahu fenë e Tij dhe që e ka ngrite, është se e ka bërë të ditur apo të njohur të Lartmadhëruarin me shikim me argumente dhe me mendje të shëndosh (me logjik).

Dhe ai person i cili beson dhe posedon teuhidin atëhere quhet Muvahid (person i cili e ka njësuar Allahun subhanehu ue te'ala), dhe e kundërta ai i cili nuk beson teuhidin, atëherë ai person quhet mushrik (politeist).

Njohja dhe rruga e tij gjinden me versetet (Ajetet) dhe me atë më të afërtën (Hadithet). Dhe çdo zanat apo (profesion) tregon në atë që e ka kryer dikush zanatin, dhe njeriu është një prej zanateve e të Lartmadheruarit, dhe Allahu është Ai i Cili është hyjni dhe Zot i gjithesisë i cili Zotëron çdo gjë me lehtësi, arsyeja e njëshmërisë e meriton adhurimin ndaj Tij, dhe qellimi i krijimit siç ka thënë i Lartmadhëruari në Librin e Tij Famëlartë: **"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë"** [Edh-Dharijat; 56]

Allahu i Lartësuar na ka krijuar për të adhuruar Atë dhe mos t'i shoqërojmë Atij askënd. Allahu i Lartësuar thotë: **"Unë nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit vetëm se për të më adhuruar Mua."** [Edh-Dharijat; 56]

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) thotë: **"E drejta e Allahut mbi njerëzit është që ta Adhurojnë vetëm Atë dhe mos t'i shoqërojnë Atij shokë."**

Ashtu si na ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij; me sinqeritet dhe sipas sunetit.

Allahu i Lartësuar thotë: **"Dhe nuk ishin të urdhëruar për tjetër vetëm se për të adhuruar Allahun me sinqeritet."** [El-Bejjineh; 5]

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) thotë: "Kush punon një vepër e cila nuk është sipas punës sonë, ajo është e kthyer

mbrapsht (nuk pranohet)". Duke adhëruar Allahun e Lartësuar me frikë nga Zjarri i Tij, me shpresë për Xhenetin e Tij dhe dashuri për Të.

Allahu i Lartësuar thotë: **"Dhe luteni Atë me frikë e shpresë" [Frikë prej Zjarrit të Tij dhe duke shpresuar Xhenetin e Tij]**. [El-A'raf: 56]

Dhe thotë: **"Atëherë Allahu do të bjerë një popull të cilin e do dhe ata e duan Atë."** [El-Maide: 54]

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) thotë: **"I lutem Allahut për Xhenetin dhe kërkoj mbrojtje prej Tij nga Zjarri."**

Adhurimi është qellimi më i madh i nënshtrimit dhe përfundon me dashurine ndaj Allahut, ekzistenca e krijuesit mbështet në adhurimin e Tij, sunduesi në renditjen dhe sjelljen e çdo sendi. Dhe për këtë e kemi marrë si Zot adhurues. Thënja (Allah) treguesi i cilësisë së Atij i Lartmadhëruar, dhe ajo është hyjnore përmbledhëse të kuptimeve të emrave të bukur dhe cilësive të larta e të plota, dhe ai i cili ndaloi politeistet me njohjen së është Zot, krijues furnizues e tek i cili nuk ka kthim tjetër kund përveç se tek Ai.

Dhe kuptimi: Allah-Adhurimet që zemra dhe nënshtrimi i takon vetëm Atij.

Njësimi në Allahun e lartësuar ndahet në tri pjesë, dhe atë siç vijon:

1-Teuhidur – Rububije

2-Teuhidul – Uluhije

3-Tevhidul – Esma'i ves-Sifat

1- Teuhidur-Rububije do të thotë; Njësimi i Allahut që Ai ka krijuar çdo send, çdo planet, çdo krijesë dhe vetëm Ai është Sundues, Furnizues, Sistemues etj... Fjala Rabb në gjuhën arabe do të thotë pronar – udhëheqës E, rububijjeti i Allahut mbi krijesat e Veta do të thotë se vetëm Ai dhe i Vetmi Ai i ka krijuar ato, se vetëm Ai është pronar dhe se vetëm Ai i mirëmbanë ato dhe udhëheqë me to. Prandaj tevhidur-rububije do të thotë pranimi se All-llahu xh.sh. është i Vetmi Krijues i të gjitha krijesave dhe i Vetmi Pronar i tyre, se vetëm Ai i ngjallë dhe i vdesë ato, se Vetëm Ai u sjellë dobi apo dëm dhe se Vetëm Ai i

pranon lutjet e krijesave, po qe se gjenden në situatë pa shtegdalje. Se vetëm Ai mund të bëjë me ta çka të dojë Vet, se vetëm Ai me të vërtetë jep dhe merr, se vetëm Ai krijon dhe se në duart e Tij janë të gjitha. Përkitazi me këtë All-llahu xh. Na thotë: **“Vetëm Ai krijon dhe sundon! I Lartësuar është All-llahu, Sundues i botëve!”** [El-A’raf: 54].

Në këtë lloj të tevhidit bënë pjesë edhe besimi në përcaktimin e All-llahut xh.sh. – besimi se çdo gjë që ndodh, ndodh me dijeninë, vullnetin dhe fuqinë e All-llahut xh.sh. Me fjalë të tjera ky lloj i tevhidit do të thoshte: të kuptuarit dhe të pranuarit se iniciator i njëmendtë që me të vërtetë vepron në këtë Gjithësi është vetëm All-llahu xh.sh. me krijimin, udhëheqjen, ndryshimin, drejtimin (e lëvizjes), rritjen dhe zvogëlimin, ringjalljen dhe vdekjen dhe me veprime të tjera, dhe se në tërë këtë askush nuk i shoqërohet Atij.

Kur’ani tejet qartë flet për këtë lloj të tevhidit. Gati se asnjë kaptinë e Kur’anit nuk e lë pa e përmendur atë, apo bile pa treguar atë në të mënyrë të zhdrejtë. Ky është themel i llojeve të tjera të tevhidit, ngase vetëm Ai është Krijues i njëmendtë, Sundues dhe Udhëheqës, i Cili meriton t’i bëhet ibadet (çdo formë e adhurimit), që T’i shprehet dhe T’i drejtohet përpulja dhe bindja. Dhe vetëm Ai është meritör që T’i drejtohet falënderimi, dhikri, dua, shpresa, droja e të ngjashme. Pra, çka do qoftë nga ibadeti mund t’i kushtohet vetëm Atij i Cili posedon pushtet absolut dhe udhëheqë me të gjitha.

Nga ana tjetër, vetëm Ai është Krijues i njëmendtë, Sundues dhe Udhëheqës, që i meriton cilësitë madhështore, të bukura dhe të përsosura. Për shkak se këto cilësi mund t’i posedon vetëm Sunduesi i të gjitha botëve, sepse, është e pamundur t’i përshkruhet pronësia dhe sundimi dikujt që nuk është i gjallë, që nuk dëgjon, nuk sheh, që është i pafuqishëm, memec, që nuk është në gjendje të bëjë atë që dëshiron vet dhe që nuk është i përkryer në të folmen e vet dhe në veprat e veta.

Andaj gjejmë se Kur'ani e përmend këtë lloj të tevhidit në kontekst të hamdit (falënderimit), të ibadetit, të nënshtrimit, të përkushtimit All-llahut xh.sh. dhe në kontekst të shpjegimit të cilësive të lartësuar dhe emrave të bukur të Tij. Në kontekstin e hamdit (falënderimit) çdo myslimanë në çdo rekatë këndon:

“Falënderimi i përket vetëm All-llahut, Zotit të botëve!” [El-Fatiha: 1]

All-llahu xh.sh. thotë: **“Pra, falënderimi i përket vetëm All-llahut, Zotit të qiejve dhe Zotit të Tokës – Zotit të Gjithësisë!”** [El-Xhathije: 36]

Në kontekstin e nënshtrimit dhe përkushtimit (devocionit) Atij, All-llahu xh.sh. thotë: **“Thuaj: “Rruga e All-llahut – është e vetmja rrugë e drejtë, dhe neve jemi të udhëruar t’i bindemi Zotit të Gjithësisë”.** [El-En’am: 71]

Në kontekstin e të drejtuarit dhe mbështetjes vetëm Atij, All-llahu xh.sh. thotë: **“Thuaj: “Me të vërtetë, namazi im dhe adhurimi im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm All-llahut, Zotit të Gjithësisë”.** [El-En’am: 162]

Në kontekstin e sqarimit se vetëm All-llahu xh.sh. mirret për mbrojtës e askush tjetër, Kur'ani thotë: **“Thuaj: “A të marr për mbrojtës dikë tjetër përveç All-llahut, Krijuesit të qiejve dhe të Tokës! Ai ushqen (botën), e Atë askush nuk e ushqen!” Thuaj: “Mua më është urdhëruar që të jem i pari nga ata që përulen”, – dhe: kurrësi mos u bënë nga ata që i bëjnë shok Atij!”** [El-En’am: 14]

Në kontekstin e duave, All-llahu xh.sh. thotë: **“Vetëm Ai krijon dhe sundon! I lartësuar është All-llahu, Zoti i Gjithësisë! Lutjuni Zotit tuaj përulshëm dhe ngadalë (në vete)! Ai, me të vërtetë, nuk i do ata që luten me zë të lartë.”** [El-A’raf: 54-55]

Në kontekstin e ibadetit, All-llahu xh.sh. thotë: **“Përse të mos e adhuroj Atë, i cili më ka krijuar. E, te Ai do të ktheheni ju?”** [Ja Sin: 22]

Gjithashtu thotë: “O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i Cili u ka krijuar juve dhe ata para jush, që të ruheni nga ndëshkimi. Zoti është Ai, që për ju Tokën e ka bërë shtrat dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej qielli lëshon shira dhe bënë që të rriten frutet, ushqim për ju. Prandaj mos i bëni me vetëdije shok All-llahut, sepse ju e dini (që Ai nuk ka shok)!” [El-Bekare: 21, 24]

Me të vërtetë, vetëm Krijuesi i qiejve, i Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet në to, është i Vetmi i Cili meriton që njeriu ta pranojë për Zot dhe për mbrojtës, dhe tërësisht t’i dorëzohet Atij, që duatë e veta t’ia drejtojë Atij dhe të mbështet tek Ai.

Nga ana tjetër vërejmë se Kur’ani ndërlidhë rububijetin e All-llahut xh.sh. – i cili pasqyrohet në sundimin e Tij me qiejt e me Tokën dhe me çdo gjë që ekziston në to – me konservimin e tyre me emrat e Tij të bukur dhe me cilësitë e Tij të lartësuar. Soditi fjalët e All-llahut xh.sh. në ajetul-Kursijj:

“All-llahu është – s’ka tjetër zot përveç Tij – i Gjalli dhe i Përjetshmi! Atë nuk e kaplon as kotja as gjumi! Të Atij janë të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë. Kush mund të angazhohet për ndokend pa lejen e Tij?! Ai di çdo gjë që ka ndodhë përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë në të ardhmen. Por, njerëzit, nuk dinë asgjë nga dijenia e Tij, përveç që Ai ka dashur t’ua tregojë. Froni (Madhëria) i Tij përfshinë qiejt dhe Tokën dhe Atij nuk i vie rëndë t’i ruajë ato. Ai është shumë i Larti, i Madhëruari!” [El-Bekare: 255]

Me të vërtetë, Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën është i Vetmi që jeton përgjithmonë dhe kurrë nuk vdes, i Cili i mirëmbanë të gjitha, di çdo gjë, kujdeset për çdo gjë, i Cili është më i Lartësuari, më Madhështori.

Pastaj përqëndrohu në këto fjalë të All-llahut xh.sh. “Ne e krijojmë njeriun dhe Na dimë çka pëshpërit shpirti i tij, sepse Ne jemi më afër se damari i qafës së tij.” [Kaf: 16]

Gjithashtu thotë: “E si mos të dinte Ai, i Cili ka krijuar çdo gjë dhe është i informuar hollësisht.” [El-Mulk: 14]

Pra, nuk ka kurrfarë dyshimi se Ai i Cili i ka krijuar të gjitha krijesat, i mbikëqyrë ato dhe se Ai di çdo gjë ç'veprojnë ato.

E, për sa i përket atyre, të cilët pranojnë se All-llahu xh.sh. është Sundues dhe Krijues i të gjithave, por nuk e veçojnë nga hyjnitë e tjerë, por së bashku me Të adhurojnë edhe të tjerët, dhe që nuk e veçojnë sipas emrave dhe cilësive të Tij, duke i mohuar ato apo duke i krahasuar ato me cilësitë e krijesave të tjera, apo duke i komentuar ato në kuptimin figurativ që nuk ka bazë, atyre tevhidi i këtij lloji nuk do t'u shërbejë dhe assesi nuk do t'i nxjerrë ata nga rrethi i mosbesimit në rrethin e imanit. All-llahu xh.sh. na tregon në Kur'an se jobesimtarët (mushrikët) kanë pranuar se All-llahu është i Vetmi Krijues, por përkundër kësaj kanë mbetur mushrikë, ngase nuk e kanë veçuar All-llahun xh.sh. në uluhijetin (hyjninë) e Tij, por i kanë adhuruar edhe të tjerët përveç Tij. Dhe për shkak se ata nuk i kanë bërë tevhid All-llahut xh.sh. në emrat dhe cilësitë e Tij, ashtu që disa i mohonin dhe nuk i besonin atyre. Prandaj All-llahu xh.sh. Thotë për ta: **“Shumica e tyre nuk i besojnë All-llahut, por i bëjnë shok Atij.”** [Jusuf: 106]

Komentatori i njohur El-Muxhahidi, gjatë komentimit të këtij ajeti thotë: **“Imani i tyre në All-llahun është pranimi se ne na ka krijuar All-llahu dhe se Ai na furnizon që të gjithëve, por ata krahas këtij pranimi i bëjnë ibadet edhe të tjerëve përveç Atij.”**

Një pjesë e dijetarëve nga gjeneratat e para ka thënë: **“Ku t'i pyesish: “Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?” Ata përgjigjen: “All-llahu”, por megjithëkëtë e adhurojnë tjetër kë.”**

All-llahu xh.sh. na thotë në Kur'an se edhe mushrikët kanë besuar se All-llahu është Krijues, Furnizues dhe Sundues: **“E, nëse i pyet kush i ka krijuar, ata, me siguri, do të thonë: “All-llahu!” E, nga po ia mbajnë atëherë?”** [Ez-Zuhruf: 87]

Dhe thotë: **“Thuaj: “Kush ju ushqen juve nga qielli dhe nga Toka? Ose, kush**

mund të krijojë të dëgjuarit dhe të pamurit? Dhe kush mund të nxjerrë të gjallin nga ivdekuri dhe të vdekurin nga i gjalli? Dhe kush i drejton gjërat? Ata do të thonë: “All-llahu!” E ti (o Muhammed!) Thuaj: “E, përse atëherë nuk i frikësoheni Atij?” [Junus: 31]

Nga ajetet e cituara shihet qartë se, gjithsecili që pranon se All-llahu është Zot i të gjithave, njëherit nuk është edhe ai që e ka besuar All-llahun si të Vetmin Zot, të Cilit i bëhet ibadet dhe i Vetmi të Cilit i përkasin të gjitha emrat e bukur dhe cilësitë e përsosmërisë. Shumica e njerëzve nuk mohojnë Krijuesin dhe udhëheqjen e Tij me krijesat, por shumë mosbesime të tyre rrjedhin nga adhurimi i tjetërkujt përveç All-llahut xh.sh.

2-Tevhidul-uluhijje do të thotë: bindshmëria e fuqishme se vetëm All-llahu xh.sh. është Zot i vërtetë dhe se tjetër zot nuk ekziston, dhe se të gjitha llojet e ibadetit (adhurimit) duhet t’i kushtohen vetëm Atij.

Fjala Ilah (Zot) në gjuhën arabe përdoret në domethënien e fjalës Me’luh (ai i cili adhurohet – atij të cilit i bëhet ibadet) E, ibadet në gjuhën arabe do të thotë të qenët i dëgjueshëm, i përlulshëm, i përvuajtshëm. Disa alimë ibadetin e kanë definuar si dashuri e sinqertë me përvuajtëri të plotë. Ibadeti i cili na është urdhëruar në vete ngërthen domethënien e përvuajtërisë, e njëkohësisht edhe domethënien e dashurisë, andaj kjo është përlulësia e plotë ndaj All-llahut xh.sh. me dashuri jashtëzakonisht të madhe ndaj Tij. Prandaj ibadeti ndaj All-llahut xh.sh. nuk është i rregullt nëse aty nuk përfshihen që të dy domethëniet e përmendura, dhe vetëm njëra prej tyre nuk është e mjaftueshme për korrektësinë e tij. All-llahu xh.sh. për ne duhet të jetë më i dashur se çdo gjë tjetër që ekziston, e njëkohësisht më i lartësuar prej të gjithëve.

Kjo pjesë e tevhidit në esencën e vet ngërthen të gjitha pjesët e tjera të besimit në All-llahun xh.sh. si Krijues dhe besimin në atë se Ai është i Vetmi që

posedon emra të bukur dhe cilësi të përsosmërisë, që nuk është rast i kundërt. Sepse, të besuarit dhe të pranuarit e All-llahut xh.sh., si Krijues dhe Sundues nuk do të thotë se i njëjti e pranon si të vetmin të cilin e adhuron.

Njeriu mund ta pranojë All-llahun xh.sh. si të Vetmin Krijues, por assesi mos ta adhurojë Atë (nuk i bënë ibadet Atij). Gjithashtu, edhe besimi në All-llahun xh.sh. si të Vetmit që i përkasin emrat e bukur dhe cilësitë e përsosmërisë (tevhidul-esma'i' ves-sifat) nuk i përfshinë llojet e tjera të tevhidit.

Por, njeriu, i cili i bënë All-llahun xh.sh. tevhidul-uluhijje, duke u bindur dhe duke e pranuar Atë si të Vetmin i Cili meriton të adhurohet (që T'i bëhet ibadet) dhe se këtë askush tjetër përveç Tij nuk e meriton nga kurrnjë aspekt, ai me këtë pranon All-llahun xh.sh. për Krijues dhe Sundues të të gjithave dhe se vetëm Atij i përkasin të gjitha emrat dhe të gjitha cilësitë e përsosmërisë, sepse ibadeti i njëmendtë mund T'i bëhet vetëm Zoti të Përsosur, e jo dikujt tjetër që nuk është Zot. Sepse, si mund të adhurohet dikush, që nuk është krijues i cili nuk udhëheq me të, dhe si mund të adhurohet dikush, që nuk është i përsosur dhe i përkryer?

Prandaj, me këtë lloj të tevhidit (tevhidul-uluhijje) ka filluar feja dhe me të ka përfunduar, kjo është forma (zahir) dhe esenca (batin) e fesë dhe për shkak të tij janë krijuar të gjitha krijesat. All-llahu xh.sh. thotë: **“Xhinnët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”** [Edh-Dharijat: 56]

Shejh Islam Ibn Tejmie thotë: “Sipas këtij lloji të tevhidit dallohen muvehhidët dhe mushrikët – ata të cilët sinqerisht adhurojnë All-llahun xh.sh. dhe ata të cilët, krahas Tij adhurojnë edhe diç tjetër – dhe për shkak të këtij do të realizohet shpërblimi apo ndëshkimi edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, e kush nuk pranon këtë, do të mbetet ndër mushrikët.”

Për shkak të këtij lloji të tevhidit janë dërguar edhe Pejgamberët dhe janë

shpallur Librat. Nuk ka ekzistuar kurrnjë Pejgamber që i është dërguar njerëzve, e që tevhidul-uluhijje të mos i jetë bazë dhe esencë e misionit të tij. All-llahu xh.sh. thotë: **“Ne çdo populli i kemi dërguar nga një Pejgamber. Të gjithë ata thonin: “Adhuroni vetëm All-llahun, e shmajiuni idhujve.”** [En-Nahël: 36]

Gjithashtu thotë: **“Ne nuk kemi dërguar asnjë Pejgamber para teje e që të mos ia kemi shpallur: “S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj adhuromëni vetëm Mua!”** [El-Enbija: 25]

All-llahu xh.sh. na informon se Pejgamberët e Tij janë: Nuhi, Hudi, Salihu, dhe Shu'ajbi, dhe çdo njëri prej tyre i ka thënë popullit të vet:

“O populli im, adhurojeni vetëm All-llahun! Ju nuk keni zot tjetër përveç Tij!” [El-Mu'minun: 23; Hud: 61; El-A'raf: 65]

All-llahu xh.sh. gjithashtu na informon se Ibrahim a.s. i ka thënë popullit të vet: **“Unë e kthej fytyrën time kah Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga ata që i bëjnë shok All-llahut!”** [El-En'am: 79]

Pra, ky lloj i tevhidit është thelbi i fesë islame, andaj sharti i parë i Islamit është kelimet shehadeti. Pejgamberi i All-llahut thotë: **“Islami bazohet në pesë gjëra: dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe Muhammedi është Pejgamber i All-llahut, kryerja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i muajit Ramazan dhe kryerja e haxhxit.”**

Të pranuarit e All-llahut xh.sh. si të Vetmin i Cili adhurohet, nga ne kërkon që vetëm Atij T'i drejtohem me çdo trajtë adhurimi dhe që zemrat tona gjatë kësaj të jenë tërësisht të pastra nga çdo drejtim tjetër. Në këtë formulim hyjnë edhe shumë gjëra të tjera. Ja disa prej tyre:

1 – Domosdoshmëria e dashurisë së sinqertë ndaj All-llahut xh.sh. Njeriu nuk

guxon që edhe në dashurinë e vetë të ketë dikë të barabartë apo përmbi All-llahun xh.sh. Prandaj, nëse dikush e do dikë sikur që e do All-llahun xh.sh., apo më tepër se Atë, atëherë ky ka bërë shirk. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ka njerëz që në vend të All-llahut marrin disa gjëra të tjera për hyjni dhe i duan ato si All-llahun; ndërsa ata që besojnë, e duan shumë më tepër All-llahun.” [El-Bekare: 165]

Në shirkun e madh, të cilin All-llahu xh.sh. nuk do ta falë, pos me pendesë për të, bën pjesë edhe ajo që njeriu ta dojë dikë tjetër përveç All-llahut siç duhet All-llahu xh.sh. Njeriu, sipas natyrës së vet, është i prirur për ta dashur vetvetën, prindërit, fëmijët, atdheun, pasurinë e të ngjashme, andaj përshtetëria (devotshmëria) e tij e sinqertë ndaj All-llahut xh.sh. nuk do të thotë asgjësim apo pengesë të kësaj ndjenje natyrore, por nga besimtari kërkohet që dashuria e tij ndaj çkado qoftë tjetër në këtë botë, të jetë pas dashurisë ndaj All-llahut xh.sh., që dashuria ndaj All-llahut xh.sh. tek ai të jetë përmbi dashuritë e tjera, kështu që të jetë i gatshëm që tërë atë që dashuron, nëse vjen gjer tek kontradikta mes asaj që kërkon nga ai dashuria ndaj All-llahut xh.sh. dhe çkado qoftë tjetër që dashuron, duhet ta sakrifikojë në emër të All-llahut xh.sh. All-llahu xh.sh. i kërcënohet atyre të cilët i japin përparësi vlerave të kësaj bote, të cilat i duan më shumë sesa All-llahun xh.sh., e thotë: **“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj, që e keni fituar, tregtia – për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë – në të cilat e ndieni veten rehat, u janë më të dashura se sa All-llahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa ta sjellë vendimin All-llahu. E, All-llahu, nuk do t’i udhëzojë mëkatarët në rrugën e drejtë.”** [Et-Tevbe: 24]

2 – Domosdoshmëria e veçimit të All-llahut në dua, në tevekkul (mbështetje) dhe në shpresë, nga aspekti se askush përveç All-llahut xh.sh. nuk është në gjendje ta plotësojë atë. All-llahu xh.sh. thotë: **“Dhe, përveç All-llahut mos iu**

lut tjetërkujt, të cilët nuk të sjellin as dobi as dëm, e nëse e bën këtë, ti atëherë, me të vërtetë, je nga pabesimtarët.” [Junus: 106]

Gjithashtu thotë: “Ata të cilët besojnë dhe të cilët emigrojnë dhe luftojnë në udhën e All-llahut, ata mund të shpresojnë mëshirën e All-llahut. Se All-llahu është mëshirues dhe falë.” [El-Bekare: 218]

3 – Domosdoshmëria e veçimit të All-llahut xh.sh. përkitazi me frikën. Ai i cili konsideron se disa nga krijesat mund t’i sjellin dëm me vullnetin dhe fuqinë e tyre personale, e nga ky shkak i frikësohen atyre, atëherë ky i ka bërë shirk All-llahut xh.sh. All-llahu xh.sh. thotë: “... **Dhe, druajuni vetëm prej Meje!**” [En-Nahël: 51]

Dhe thotë: “Nëse All-llahu të sjellë ndonjë dëm, askush nuk mund të ta largojë, përveç Tij, e nëse Ai don të ta bëjë ndonjë të mirë, s’ka kush të ta pengojë mirësinë e Tij. Ai ia jep atë mirësi kujt të dojë nga robërit e Tij; dhe Ai është falës dhe mëshirues.” [Junus: 107]

4 – Domosdoshmëria e veçimit të All-llahut xh.sh. në të gjitha llojet e ibadetit trupor, siç është namazi, ruku’a, sexhdeja, agjërimi, therja (e kurbanit), tavafi dhe të gjitha format e ibadetit gjuhësor, siç është betimi, kërkim ndjese etj.

Ky dhe çdo lloj tjetër i ibadeteve duhet t’i kushtohen vetëm e vetëm All-llahut xh.sh., e ai i cili çkado qoftë prej tyre i kushton dikujt tjetër, përveç All-llahut xh.sh., ai i ka bërë shirk. All-llahu xh.sh. thotë: “**All-llahu, me të vërtetë, nuk e falë atë që i bën shok Atij, por ia falë tjerat mëkate kujt të dojë (përveç këtij).** Kushdo që t’i bëjë shok All-llahut, ai me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë.” [En-Nisa: 116]

3- Tevhidul-esma'i ves-sifat: do të thotë bindshmëria e fuqishme se All-llahut xh.sh. i përkasin të gjithë emrat e bukur dhe cilësitë e përsosmërisë, se Ai është larg attributeve të mangëta dhe se Ai me cilësitë e Tij shquhet mbi të gjitha krijesat. Cilësitë dhe emrat të cilat na janë të njohura vetëm nga fjalët e Tij dhe nga fjalët e Pejgamberit të Tij, pa kurrfarë ndryshimesh të fjalëve të tyre, pa mohimin e tyre parcial apo të tërësishëm, pa tentim që tërësisht të kuptohen ato dhe të shpjegohen thelbësisht apo komparacionet me cilësitë e krijesave.

Nga ky formulim jipet të kuptohet se tevhidul-esma'i ves-sifati, bazohet në tri parime, e, kush largohet prej tyre, ai nuk do të jetë besimtar në këtë lloj të tevhidit.

- a) Të besuarit se All-llahu xh.sh. nuk i gjason krijesave dhe se është larg çdo të mete.
- b) Të besuarit në emrat dhe në cilësitë e All-llahut xh.sh. që janë përmendur në Kur'an dhe në Sunnet, pa kurrfarë mungese apo shtimi dhe pa kurrfarë shtrembërimesh apo mohimesh; dhe
- c) Shuarja e çdo dëshire për të kuptuar domethënien e vërtetë të këtyre cilësive.

1) Me parimin e parë nënkuptohet mohimi i çdo ngjashmërie ndërmjet cilësive të All-llahut xh.sh. dhe cilësve të krijesave. Argument për këtë janë fjalët e All-llahut xh.sh. **“Dhe askush nuk i gjason Atij!”** [El-Ihlas: 4]

Gjithashtu I Lartëmadhëruari thotë: **“All-llahun mos e krahasoni me kurrgjë!”** [En-Nahël]

Imam Kurtubiu, duke komentuar ajetin “Dhe askush nuk i gjason Atij!” thotë: “Këtu flitet se All-llahut xh.sh. me lartësinë e Tij, në madhësitë e Tij, me pushtetin e Tij, me emrat e bukur dhe me cilësitë e përsosura të Tij, nuk i gjason askush nga krijesat e Tij, e as që mund krahasohet ndokush të me Të. Gjithashtu edhe cilësitë e All-llahut xh.sh. të cilat janë përmendur në Kur’an dhe në Sunnet, e ato janë të përbashkëta sipas shqiptimit në raport me All-llahun xh.sh. dhe krijesat e tjera, assesi nuk i gjasojnë domethënies së vërtetë të tyre, ngase cilësitë e Atij që gjithmonë ekziston nuk janë të njëjta sikurse cilësitë e atyre të cilët janë krijuar nga Ai.”

Sejjid Kutubi në tefsirin e vet, duke komentuar këtë ajet, thotë: “Natyra e njeriut në tërë këtë beson vetvetiu, ngase gjërat e krijuara, të cilat i ka krijuar ai vetë, njëherit nuk mund t’i përngjajnë krijuesit.”

Në këtë parim bënë pjesë edhe mohimi i çdo gjëje që i kundërvihet asaj me çka All-llahu xh.sh. e ka përshkruar Vetveten, ose me çka e ka përshkruar Pejgamberi i Tij. Prandaj besimi në All-llahun xh.sh., si të Vetmit që i përkasin emrat dhe cilësitë e përsosmërisë, kërkon prej nesh të mohojmë dhe të dëbojmë mundësinë se Ai mund të ketë grua, shok, partner (ortak), ndihmës, ndërmjetsues (përveç me lejen e All-llahut) dhe mbrojtës nga poshtërimi. Siç kërkon edhe mohimin se Atë mund ta kaplojë kotja dhe gjumi, lodhja, kapitja, vdekja, padrejtësia, shkujdesja, harresa, pagjumësia, transformimi dhe cilësi të tjera mangësie.

2) Parimi i dytë kërkon obligueshmërinë e kufizimit të çdo gjëje që i përshkruhet All-llahut xh.sh. vetëm në atë që është përmendur në Kur’an dhe në hadithet e Pejgamberit a.s. Sepse, cilësitë dhe emrat e All-llahut xh.sh. kuptohen me anë të të thënave, e jo me anë të përsiatjes personale. All-llahu xh.sh. assesi nuk mund të përshkruhet, përveçse me atë që e ka përshkruar Vetveten apo me çka e ka përshkruar Pejgamberi Tij. Gjithashtu edhe nuk emërohet, përveçse me emrat me të cilat e ka quajtur

Vetveten apo me të cilat e ka quajtur Pejgamberi i Tij. Për shkak se All-llahu xh.sh. i di më së miri emrat dhe cilësitë e Vet. All-llahu xh.sh. thotë: "... **Thuaj: "A e dini më mirë ju apo All-llahu?"** [El-Bekare: 140]

Duke qenë se All-llahu xh.sh. e di më së miri për Vetveten, dhe pasi që Pejgamberët e Tij e kanë folur vetëm të vërtetën, sepse ata kanë transmetuar vetëm atë që u ka shpallur All-llahu xh.sh., atëherë, në sferën e emrave dhe të cilësive të All-llahut xh.sh. – duke i pranuar ato – jemi të obliguar t'i përmbahemi asaj që na ka informuar All-llahu xh.sh. dhe Pejgamberi i Tij. **Imam Hambeli** thotë: "All-llahu xh.sh. nuk përshkruhet, përveçse me atë që e ka përshkruar Vetveten, apo me çka e ka përshkruar Pejgamberi i Tij, duke mos e tejkaluar aspak Kur'anin dhe Hadithin."

Nu'Ajm bin Hammad – mësuesi i Buhariut – ka thënë: "Ai i cili e krahason All-llahun xh.sh. me krijesat e Tij, ai ka bërë kufër, kush mohon çkado qoftë nga ajo me çka All-llahu xh.sh. e ka përshkruar Vetveten apo me çka e ka përshkruar Pejgamberi i Tij, ai ka bërë kufër, dhe ajo me çka All-llahu xh.sh. e ka përshkruar Vetveten dhe me çka e ka përshkruar Pejgamberi i Tij nuk mund të barazohet me asgjë dhe nuk mund të krahasohet me asgjë."

Ky parim kërkon nga çdo njeri i moshës madhore – moshës ligjore sipas Sheriatit – që të besojë tërë atë që transmetohet nga emrat dhe cilësitë e All-llahut xh.sh. në Kur'an dhe në Sunnetin e Pejgamberit a.s. Dhe t'i pranojë ato sipas domethënieve të tyre të qarta dhe parimore në gjuhën arabe, duke mos mohuar diç prej tyre dhe duke mos shtrembëruar diç gjatë komentimit duke u larguar nga domethënia e tyre.

3) Parimi i tretë kërkon nga njeriu që t'i besojë të gjitha cilësive të përmendura në Kur'an dhe në Sunnet, pa pyetje për esencën e tyre dhe për domethënien e tyre të vërtetë (lidhur me All-llahun xh.sh.). Sepse, të konceptuarit e cilësive bazohet në të konceptuarit e qenies, sepse, cilësitë dallohen në ujdi me dallimin e bartësve të tyre. Sikurse që assesi nuk

pyesim për qenien e All-llahut xh.sh. dhe kualitetin e Tij, po ashtu assesi nuk është korrekte të pyesim për cilësitë e Tij. Prandaj transmetohet nga një numër i madh i gjeneratave të para (selef) se, kur i patën pyetur për ngritjen (el-istiva) e All-llahut xh.sh, ishin përgjegjës: “Ngritja është e njohur, ndërsa mënyra e saj është e panjohur, të besuarit në të është vaxhib e pyetja për mënyrën e saj është bid’at.”

Pra, selefët janë pajtuar se mënyra (e ngritjes së All-llahut xh.sh.) është e panjohur për ne dhe se pyetja për të është bid’at. Andaj sikur të na pyeste dikush: “Në ç’mënyrë Zoti ynë zbret në qiellin botëror?” Ne do ti thoshim: “Si duket Ai?” E, nëse thotë se nuk e di se si duket Ai, ne do t’i thoshim: “Ne nuk dimë se si zbret Ai, sepse dituria për atributin kërkon dituri mbi bartësin e atij atributi. E, si mund të kërkosësh prej nesh të të shpjegojmë në ç’mënyrë All-llahu xh.sh. dëgjon, sheh, flet, si ngritet dhe si zbret, e ti nuk e di se si duket Ai? Nëse ti pranon se All-llahu xh.sh. dhe eksiztenca e tij është me të gjitha cilësitë e përsosmërisë dhe se askush nuk i gjason Atij, ngjashëm me këtë është edhe të dëgjuarit dhe të pamurit e Tij, zbritja dhe ngritja e Tij, është fakt i vërtetë, e që njëkohësisht nuk i gjason shqisës të të dëgjuarit të krijesave, të të pamurit, të folurit, zbritjes dhe ngritjes së tyre.”

Me sa ekspozuam më lartë, rezulton se këtë lloj të tevhidit e trazojnë disa gjëra, të cilat myslimani nuk do të guxonte t’i lejojë vetes:

1- Et-teshbih – krahasimi i cilësive të All-llahut xh.sh. me cilësitë e krijesave (antropomorfizmi), siç e krahasojnë të krishterët Isain a.s. (të birin e Merjemës), hebrenjtë Uzejrin, e mushrikët idhujt e tyre më All-llahun xh.sh. Apo, sikurse që disa sekte e krahasojnë fytyrën e All-llahut xh.sh. me fytyrën e krijesave, dorën e Tij me dorën e krijesave, të dëgjuarit e Tij me të dëgjuarit e tyre e të ngjashme.

2- Shtrembërimi i domethënies së cilësive të All-llahut xh.sh. me komentime,

dhe çfarëdo ndërrimi dhe zëvendësimi në to (et-tahrif bit te'vil), siç është shtrembërimi i fjalëve, emrave dhe cilësive duke shtuar, duke munguar apo duke ndërruar herektet (konsonantet) në fjalë, siç kanë vepruar disa me fjalët e All-llahut xh.sh.: "... **E, All-llahu, me siguri, ka biseduar me Musain.**" [En-Nisa: 164] – kështu që ne vend të damme-s në fjalën All-llah e kanë vënë fet'h-in, në mënyrë që domethënia të jetë se All-llahu nuk ka folur me Musain, por Musai ka folur me All-llahun.

Rruga më e drejtë përkitazi me cilësitë e All-llahut xh.sh. është drejtimi i gjeneratave të para myslimane (selef), të cilët i kanë përshkruar All-llahut xh.sh. atë që Ai i ka përshkruar Vetes dhe atë që ia ka përshkruar Pejgamberi i Tij, pa alegori, me të cilat mohohen cilësitë dhe pa komparacione të cilat nuk i përshtaten Madhërisë dhe Unitetit (vahdaniijetit) të All-llahut xh.sh.

Prandaj e tërë ajo që përmendet në Kur'an dhe në hadithe autentike, siç është dora, fytyra, ngritja, zbritja, hidhërimi, kënaqësia dhe cilësitë e tjera, ne ia përshkruajmë All-llahut xh.sh., pa krahasime me cilësitë njerëzore dhe pa komentime alegorike të cilat shpiejnë në mohimin e tyre.[ii] Dhe themi ashtu siç ka thënë imam Shafiu: "E besoi All-llahun dhe tërë atë çka ka ardhur nga All-llahu ashtu siç dëshiron Vetë Ai dhe e besoj Pejgamberin e All-llahut dhe tërë atë që ka ardhur prej tij ashtu siç ka menduar dhe siç ka dëshiruar ai."

3- Et-ta'til – Të kuptuarit se All-llahu është i privuar nga të gjitha atributet, mohimi i cilësive të All-llahut xh. sh dhe kundërshtimin e lidhshmërisë së tyre me qenien e All-llahut xh.sh. Siç është mohimi i përsosmërisë së plotë të All-llahut xh.sh. me anë të kundërshtimit të emrave dhe të cilësive të Tij. Apo mohimi i ndërsjelljes me All-llahun xh.sh. duke lënë ibadetin, ose mohimi i lidhjes mes krijesave dhe Krijuesit të tyre, ose, siç konfirmojnë disa, që materia ka ekzistuar gjithnjë (nuk është krijuar) dhe se All-llahu xh.sh. nuk e ka krijuar atë.

4- Et-tekjif – shqyrtimi mbi kualitetin: caktimi i kualitetit të cilësive të Zotit

xh.sh. dhe të konstatuarit e esencës së tyre.

Pranimi i vërtetë i cilësive dhe i emrave të All-llahut xh.sh., të cilat janë përmendur në Kur'an dhe në Sunnet, në domethënien e tyre origjinare, pa bërë krahasime, shtrembërime, mohime dhe polemizime mbi kualitetin e tyre, ka qenë drejtimi (medhhebi) i selefëve – as'habëve, tabi'inëve, dhe tabi tabi'inëve. Esh-Shevkani thotë: "Drejtimi i selefëve nga as'habët, tabi'inët dhe tabi tabi'inët është pranimi dhe transmetimi i argumenteve (teksteve) mbi cilësitë e All-llahut xh.sh. në domethënien e tyre rrënjësore, pa kurrfarë shtrembërimesh, alegorishë tejet të theksuara, komparacionesh dhe mohimesh kah shpie pjesa më e madhe e te'vilit (komentimit figurativ). Ata, nëse i pyeste dikush për diçka lidhur me cilësitë e All-llahut xh.sh., i citonin argumentet dhe përmbaheshin nga thashethemet, duke thënë: "All-llahu xh.sh. ka thënë kështu, dhe ne asgjë më tepër nuk dimë lidhur me këtë, dhe nuk tentojmë të flasim për atë që nuk dimë, e as që na ka dhënë të drejtë All-llahu xh.sh. ta tejkalojmë këtë." E, nëse pyetsi megjithatë përpiquej të kuptojë diç më tepër përkitazi me këtë, ata e qortonin duke ia ndaluar të interesohet për atë që nuk i përket atij dhe të kërkojë diç që është e pamundur të arrihet, përveçse duke hyrë në bid'at i cili është jashtë asaj në çka bazoheshin ata, e që e kanë mbajtur mend nga Pejgamberi i All-llahut xh.sh., e tabi'inët nga as'habët dhe tabi tabi'inët nga tabi'inët. Në këta shekuj të famshëm ka mbretëruar qëndrimi unanimit përkitazi me cilësitë e All-llahut xh.sh. Ata kujdeseshin për atë që u ka urdhëruar All-llahu xh.sh. dhe bëni atë që u ka urdhëruar ta bëjnë, duke filluar nga emrat e All-llahut xh.sh. e gjer tek namazi, dhënia e zekatit, agjërimi, haxhxi, xhihadi, ndarja (dhënia) e pasurisë për qëllime bamirësie, që është garancë e fitimit të Xhenetit dhe shpëtimit nga zjarri i Xhehennemit. Pastaj, kujdeseshin për të udhëzuar në të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja, e pengonin përdhunuesin nga trazirat me të gjitha mjetet që i kishin në disponim, dhe nuk interesoheshin për asgjë tjetër që All-llahu xh.sh. nuk ka kërkuar prej tyre, e as që i ka obliguar të kuptojnë esencën e tij.

Prandaj atëbotë feja ka qenë e pastër nga bidatet.

• Ç'farë e prish Teuhidin

Teuhidin e prish shirku dhe llojet e saja.

1- **Shirku në Adhurim** (të bërit Allahut ortak, shok gjatë adhurimit).

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “S’ka dyshim se Allahu nuk falë (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do. Kush përshkruan Allahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh”. [Nisa: 48]

Dhe thotë: “Bënë kufër (mohuan të vërtetën) ata që thanë: ‘Allah është ai, Mesihu, biri i Merjemes’. E vetë Mesihu (Isai), tha: ‘O Beni Israilë, adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij Xhenetin dhe vendi i tij është zjarri’. Për mizorët nuk ka ndihmës”. [Maide: 72]

Prej llojeve të shirkut është therja e kurbanit për dikë tjetër pos Allahut, ashtu siç i therin për xhinët dhe nëpër varreza. Autori, Muhamed ibën Abdulvehabi, i filloi këto dhjetë negacione me shirkun, ngase është mëkati më i madh, që e shkatërron rububietin e Allahut, subhanehu ve teala, dhe mangëson uluhjetin. Shirk është të barazohet dikush krahas Allahut me Allahun, subhanehu ve teala, në atë që është prej veçorive të Allahut. Si nuk është mëkati më i madh me të cilën i bëri Allahut, subhanehu ve teala, ortak dhe shok në adhurim, pasi që e krijoi prej asgjëje dhe i dhuroj shumë mirësi?!

Shirku ndahet në tre lloje:

1. Shirku i madh
2. Shirku i vogël
3. Shirku i fshehtë

Ibën Kajimi anon kah mendimi se shirku ndahet në dy lloje: Shirku i madh dhe shirku i vogël.

1-Shirku i madh

Shirkun e madh nuk e fal Allahu, subhanehu ve teala, vetëm se me pendim. Personi nëse e takon Allahun, subhanehu ve teala, duke i bërë shirk të madh, do të jetë përgjithmonë në zjarr.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: **“S’ka dyshim se Allahu nuk falë (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do. Kush përshkruan Allahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh’.** [Nisa: 48]

Dhe thotë: **“Duke qenë të sinqertë në besimin ndaj Allahut, dhe duke mos i përshkruar Atij shok, e kush i përshkruan shok Allahut, ai është sikur të bie nga qielli e ta rrëmbejë shpendi, ose si ai të cilin e gjuan era e stuhishme në ndonjë vend të humbur”.** [El Haxh: 31]

Për këtë mushrikët, idhujtarët, adhuruesit e varreve dhe të tjerët iu drejtohen zotave të tyre në zjarr. **“Pasha Allahun, njëmend ne kemi qenë krejtësisht të humbur! Kur juve (idhuj) u kemi barazuar me Zotin e botëve”.** [Shuara: 97, 98]

Idhujtarët nuk i barazonin Zotat e tyre me Allahun, subhanehu ve teala, në krijim, në ushqim, ngjallje dhe as në vdekje, por e barazuan në dashuri, e cila është thelbi i adhurimit, po ashtu i barazuan në madhërinë e cila është një vepër prej veprave më të mira dhe adhurim prej adhurimeve më të ngritura dhe lartësuara.

Për këtë Allahu i nënçmoi ata të cilët nuk e lartësojnë dhe madhërojnë Atë, subhanehu ve teala: **“Ç’është me ju që Allahut nuk i shprehni madhërinë që e meriton?”** [Nuh: 13]

Andaj ne themi se dëmi, degjenerimi i tërësishëm kthehet në të bërit shok dhe ortak Allahut, subhanehu ve teala.

Shirku i madh është i shumëllojshëm, kthehen në katër llojet kryesore, andaj do t'i cekim sipërfaqësish duke shpjeguar shkurtimisht që mos të zgjasim, megjithëse të folurit në këto çështje është mëse e kërkuar, por pas zvogëlimit të ambicieve shkurtimisht do të cekim atë çka ka dobi.

1. Shirku në lutje (adhurim)

Argument për këtë është fjala e Allahut:

“(Idhujtarët e dinë për Allahun pse) **Kur hipin ata në anije** (u këputet lidhja me tokën dhe frikësohen) **i luten sinqerisht Allahut, e kur i shpëton ata** (dhe dalin) **në tokë, qe, po ata të njëjtit i lusin idhujt!**”. [Ankebut: 65]

Imam Temimi, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij **“Katër themelet”** thotë:

Baza e katërt. Mushrikët (idhujtarët) e kohës tonë i bëjnë Allahut shirk më shumë dhe më keq se mushrikët e parë, ngase të partë i bënë ortak Allahut duke qenë të sigurtë dhe në rahatë dhe ishin të sinqertë në vështirësi, kurse idhujtarët (mushrikët) e kohës tonë i bëjnë shok (ortak) Allahut në rahatë dhe vështirësi. Thotë autori në parathënien e librit **“Katër themelet”**:

“Nëse futet shirku në adhurim, e prish adhurimin ashtu siç e prish urina abdesin. Nëse e din se kur shirku përziehet me adhurimin – e prish, asgjëson veprën dhe vepruesi i saj është prej banorëve të përgjithmonshëm të zjarrit, atëherë kupton se vepra më e rëndësishme është, të mësuarit e shirkut që ndoshta Allahu të na shpëton prej këtij rrjeti të rrezikshëm, e kjo është shirku, të bërit shok Allahut”.

2. Shirku në qëllime (nijeti)

Argument për këtë është fjala e Allahut:

“Kush ka për qëllim jetën e kësaj bote dhe të mirat e saj, Ne do t’ua plotësojmë atyre shpërblimin e veprave të tyre në të, dhe atyre nuk do t’u mungojë gjë. Të

këtyllëve në botën tjetër u përket vetëm Xhehenemi. Ajo që punuan dhe vepruan ata ka dështuar dhe është asgjësuar”. [Hud: 15-16]

Dijetari i njohur **Ibën Kajimi**, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Sa i përket shirkut në qëllime është një det i pafund, pak prej njerëzve shpëtojnë nga ky shirk, kush ka për qëllim në veprën e tij dikë tjetër krahas Allahut, subhanehu ve teala, apo ka qëllim diçka tjetër e jo afrimin tek Allahu, duke kërkuar shpërblim prej Tij, vetëm se i ka bërë Allahut shok në qëllim dhe nijet. Shirku në qëllime llogaritet si shirk i madh nëse të gjitha veprat janë për dikë tjetër krahas Allahut, kurse nëse ka dyfaqësi është shirk i vogël”.

3. Shirku në nënshtrueshmëri dhe respektim:

Të nënshtruarit priftit (çifut) e murgut (krishterë) dhe parisë së tyrë, për t'i bërë mëkat Allahut, subhanehu ve teala, siç thotë Allahu, subhanehu ve teala: **“Ata i konsideruan ‘ahbarët’ (priftër jehudi) të tyre, ‘ruhbanët’ (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos Allahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga pejgamberët) pos për adhurimin ndaj Allahut një, e që nuk ka të adhuruar tjetër pos Tij. I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë”**. [Teube: 31]

Prej asaj çka e shpjegon këtë ajet dhe e qartëson është hadithi të cilin e transmeton Tirmidhiu dhe të tjerët nga Adij ibën Hatim se e ka dëgjuar Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem, duke e lexuar këtë ajet **“Ata i konsideruan ‘ahbarët’ (priftër jehudi) të tyre, ‘ruhbanët’ (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos Allahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga pejgamberët) pos për adhurimin ndaj Allahut një, e që nuk ka të adhuruar tjetër pos Tij. I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë”**, i thashë: “O i dërguari i Allahut, ne nuk i adhurojmë ata!”. Tha: “A nuk ua ndalonin atë të cilën Allahu e bëri të lejuar dhe ju e ndalonit, a nuk ua lejonin atë të cilën Allahu ua ndaloi dhe ju i lejuat”. Thashë: Po. Tha: “Ky

është adhurimi i tyre". Zinxhiri i hadithit është i dobët, por ka hadith tjetër i cili dëshmon për këtë tek Ibni Xheriri nga Hudhejfeja, radijallahu anhu. Por komentimi i këtij ajeti me këtë që cekëm më lartë është e njohur tek dijetarët e tefsirit dhe nuk ka në mesin e tyre ndonjë që nuk e pranon këtë komentim.

Shejh Islam Ibn Tejme, rahimeullah, thotë:

“Ata të cilët i morën priftërinjtë dhe murgjit për zota, iu nënshtruan në lejimin çka i ndaloi Allahu, subhanehu ve teala, dhe ndalimin çka e lejoi Allahu, subhanehu ve teala, ky manifestim është në dy mënyra:

I–Nëse e din se këta e kanë ndryshuar fenë e Allahut dhe i ndjekin në këtë ndryshim, besojnë lejimin çka e ndaloi Allahu dhe ndalimin çka e lejoi Allahu duke e ndjekur parinë, kurse ata e dinë se këta kundërshtuan fenë e pejgamberëve kjo është kufër (dalje nga feja), i kanë bërë Allahut dhe Pejgamberit shok dhe ortak edhe pse nuk i adhuronin këta udhëheqës dhe nuk ju bënin sexhde atyre. Ai i cili ndjek dikë tjetër në të kundërtën e fesë duke e ditur këtë dhe beson se atë çka e thotë ky është më poshtë se fjala e Allahut dhe Pejgamberit është kafir sikur këta.

II–Të jetë besimi i tyre dhe bindja se të lejuarit dhe ndaluarit është veçori e Allahut, subhanehu ve teala, por iu nënshtruan në të bërit mëkat Allahut ashtu siç vepron muslimani prej mëkateve të cilët beson se janë mëkate. Vendimi, dispozita e këtyre (dhe ata të cilët janë si këta) është sikur tjerët prej mëkatarëve.

4. Shirku i dashurisë

Argument për këtë është fjala e Allahut:

“E nga njerëzit ka asish që në vend të Allahut besojnë idhujt, që i duan (i madhërojnë) ata, sikur (që besimtarët e vërtetë e duan) Allahun, po dashuria e atyre që besuan Allahun është shumë më e fortë. E sikur të dinin ata që bënë mizori se kur do ta shohin dënimin (në botën tjetër), do të binden se e tërë fuqia i takon vetëm Allahut (e jo idhujve) dhe se Allahu është ndëshkues i

rreptë". [Bekare: 165]

Politeistët dhe idhujtarët me injorancën ndaj zotit të tyre, i vëren se i duan zotat prej putave (idhujve) dhe tjerët, ashtu siç e duan Allahun, ndoshta edhe më shumë, e vëren nëse nënçmohet (zoti i tij) idhulli hidhërohet për të më shumë se sa për Allahun, subhanehu ve teala. Gëzohet për putat e tij më shumë se sa gëzohet për Allahun. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: **"Kur përmendet vetëm Allahu, zemrat e atyre që nuk besojnë botën tjetër neveriten, e kur përmenden, përveç Atij, të tjerë, ata gëzohen"**. [Zumer: 45]

Dijetari i madh **Ibën Kajimi** thotë:

"Ekzistojnë katër lloje të dashurisë, duhet t'i dallojmë, ngase është humbur kush është humbur duke mos i dalluar këta lloje:

1. Dashuria e Allahut, subhanehu ve teala.

Kjo dashuri nuk mjafton për të shpëtuar nga zjarri e as për të fituar Xhenetin, ngase politeistët, idhujtarët, krishterët dhe çifutët e tjerë e donin Allahun, subhanehu ve teala.

2. Të dashurit atë çka e donë Allahu, subhanehu ve teala.

Ky lloj i dashurisë është ai çka e fut njeriun në Islam dhe e largon prej kufrit, më i dashuri prej njerëzve është ai i cili e praktikon më së shumti këtë dashuri.

3. Dashuria për Allahun, subhanehu ve teala.

Kjo dashuri është fryt i dashurisë çka e don Allahu, subhanehu ve teala, ngase nuk trajtohet dashuria atë çka e donë Allahu vetëm nëse duhet për Allah.

4. Dashuria me Allahun, subhanehu ve teala.

Kjo dashuri është shirk, çdokush kush don dikën me Allahun, subhanehu ve teala, dhe as për shkak të Allahut, subhanehu ve teala, vetëm se e ka marrë ortak krahas Allahut, subhanehu ve teala, kjo është dashuria e politeistëve, idhujtarëve.

Këto katër lloje të shirkut të madh të nxjerrin prej Islamit, ngase janë adhurime.

Të kushtuarit e adhurimeve dikujt pos Allahut është shirk siç e cek Allahu në Kur'an: **“E kush adhuron me Allahun edhe ndonjë zot tjetër, për të cilin nuk ka kurrfarë fakti, përgjegjësia e tij është para Zotit të vet, e mohuesit nuk do të shpëtojnë”**. [El Mu'minun: 117]

I emërtoj Allahu këta kafira për shkak të lutjes tjetërkujt krahas Allahut. Gjithashtu prej shirkut të madh është të theret kurban për dikë tjetër krahas Allahut, ngase therja e kurbanit është afrim dhe adhurim prej adhurimeve më të madhëruara. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: **“Andaj ti falu dhe prej kurban për hir të Zotit tënd!”** [Keuther: 2]

Dhe thotë: **“Thuaj. Namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve”**. [El En'am: 162]

Kush therë kurban për njerëz të mirë (elvia), idhuj, apo për ndonjë xhin siç veprojnë shumica e injorantëve në disa vende dhe periferi të Mekes tek Sukna el-Menzil kanë dalur prej fesë islame dhe janë futur nën ombrellën e kufrit dhe humbjes, ngase si të tillë i kushtuan një adhurim prej adhurimeve më të madhëruara tjetërkujt pos Allahut.

Të zotuarit për dikë tjetër krahas Allahut është shirk i madh, ngase zotimi është adhurim siç thotë Allahu: **“Ata janë që i zbatojnë premtimet e tyre dhe i frikësohen një dite dëmi i së cilës ka përmasa të mëdha”**. [Insan: 7]

Dhe thotë: **“Allahu di për atë që e keni dhënë nga pasuria ose keni zbatuar ndonjë premtim (nedhër), e për ata mëkatarët nuk ka ndonjë ndihmëtarë”.**

[El-Bekare: 270]

Kush zotohet për elvijatë me qirinj apo mish dhe gjëra tjera vetëm se ka dalur prej fesë (Islamit), ngase një gjë e tillë nuk lejohet vetëm se për Allahun, kush e drejton zotimin e tij për tjetër e jo për Allahun me të vërtetë e kundërshton atë me çka ka ardhur Muhamedi, salallahu alejhi ve selem.

Atë çka e bëjnë adhuruesit e varrezave në shtetet fqinje etj, të zotuarit për atë çka besojnë se sjell dëm dhe dobi është shirk i madh, nxjerrës nga Islami, ai i cili thotë se është shirk i vogël ka gabuar shumë dhe ka folur me injorancë. Gjithashtu shirk i madh është të kërkuarit mbrojtje dhe shpëtim nga dikush tjetër pos Allahut.

2-Shirku i vogël

Vepruesi i shirkut të vogël është nën mëshirën e Allahut, ky është mendimi më i saktë nëse don Allahu ia falë dhe e fut në Xhenet e nëse don e dënon, por fundi i tij do të jetë Xheneti, ngase shirku i vogël nuk e bën njeriun të qëndron në Xhehenem përgjithmonë, por i kanoset dënimi, andaj duhet të kemi kujdes nga shirku i vogël.

Prej llojeve të shirkut të vogël është të betuarit në dikë tjetër pos Allahut, nëse nuk ka qëllim ta lartësojë dhe madhërojë, ngase përndryshe bëhet shirk i madh. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thotë: **“Kush betohet në dikë tjetër pos Allahut ka bërë kufër apo shirk”.**

Negacioni i dytë

Shejh Muhamed ibën Abdulvehabi: **“Kush merr (bën) mes tij dhe mes Allahut, salallahu alejhi ve selem, ndërmjetësues, i lutë ata, kërkon shefat (ndërmjetësim) prej tyre dhe mbështetet tek ata, ka dalur prej Islamit me pajtimin e të gjithë dijetarëve islamë”.**

Ky negacion është prej negacioneve që më së shumti veprohet dhe më i rrezikshmi për njeriun, ngase shumica prej të cilëve e thërrasin vetën musliman, kurse ai nuk e njeh Islamin e as realitetin e Islamit. Kanë marrë mes tij dhe Zotit ndërmjetësues, i lusin ata për t'ia larguar vështirësitë dhe ndihmuar (shpëtuar) nga sprovat, këta janë kafira me pajtimin e të gjithë muslimanëve, ngase Allahu, subhanehu ve teala, nuk i zbriti librat dhe nuk i dërgoi Pejgamberët vetëm që të njësohet Allahu në adhurim e mos ti bëhet shok, ortak, shirk. Por refuzuan adhuruesit e varreve dhe morën ndërmjetësues, i pyesin dhe lutin për t'u ofruar dobi dhe për t'ua larguar dëmin, dhe e llogaritën këtë se ky është adhurimi për të cilën urdhëroi Allahu, subhanehu ve teala. Kush i kundërshton ata në këto vepra të shëmtuara e etiketojnë se ky nuk i madhëron, nuk i respekton evlijatë dhe të devotshmit. Këta me pretendimin e tyre të çoroditur, se nuk e lusin Allahun, subhanehu ve teala, drejtpërdrejt ngase e madhërojnë Allahun dhe thonë Allahut i nevojiten ndërmjetësues (patjetër duhet të ketë ndërmjetësues për te Allahu), ashtu siç nuk kërkohet nga mbretërit vetëm se me ndërmjetësues, atëherë Allahu ka më shumë prioritet se mbreti!

Këta nuk kërkojnë mbrojtje prej Allahut, subhanehu ve te'ala, Por e përngjasojnë Atë me krijesën e dobët (njeriun), me këtë krahasim dhe nga kjo rrugë u futën derisa dolën prej Islamit.

Në librin e Allahut, subhanehu ve teala, dhe Sunetin e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, ka shumë argumente të cilët e prishin dhe kundërshtojnë këtë fjalë. Kush e mediton Kur'anin duke kërkuar udhëzim dhe për ta gjetur të vërtetën do ta kupton se feja islame është e njohur dhe e qartë dhe se shumica e njerëzve janë injorant në (në këtë) fenë e Zotit të botëve, prej këtyre argumenteve është edhe fjala e

Allahut, subhanehu ve teala: **"Thuaj, 'Thirrni ata, të cilët i menduat për zota pos Allahut!'. Ata nuk posedojnë sa një grimcë as në qiej e as në tokë dhe as që kanë në to ndonjë pjesë, dhe Ai nuk ka prej tyre ndonjë përkrahje.**

Dhe ndërmjetësimi nuk bën dobi te Ai, përveç i atij të cilit i jep leje, e kur

hiqet frika nga zemrat e tyre (të ndërmjetësuesve), ata thonë: “Çka tha Zoti juaj?” (rreth shefatit). Ata (engjëjt e lartë) thonë: “Të vërtetën!” (u dha leje). Ai është më i larti, më i madhi”. [Sebe: 22-23]

Gjithashtu thotë: “Dhe mos lut tjetërkë pos Allahut, ndonjë (idhull) që nuk të sjellë as dobi as dëm, e nëse e bën atë, dije se i ke bërë padrejtësi vetvetes. Nëse Allahu të provon me ndonjë të keqe, atë s’mund ta largojë kush pos Tij, po nëse dëshiron të japë ndonjë të mirë, s’ka kush që mund ta pengojë dhuntinë e Tij. E shpërblen me të atë që do nga robërit e Tij. Ai falë dhe mëshiron shumë”. [Junus: 106-107]

Gjithashtu thotë: “Po nëse i pyet ata se kush i krijoi qiejt e tokën, sigurisht ata do të thonë: ‘Allahu!’. Ti thuaju: ‘Më tregoni pra, për ata që i adhuron pos Allahut, nëse Allahu më godet mua me ndonjë të keqe, a mund ta largojnë ata atë të keqe, ose nëse Allahu dëshiron ndonjë të mirë ndaj meje, a mund ta pengojnë ata të mirën e Tij?’. Thuaju: ‘Mua më mjafton Allahu. Vetëm Atij i mbështeten të mbështeturit’”. [Zumer: 38]

Në Kur’an ka edhe më shumë argumente që aludojnë në obligimin e sinqeritetit në adhurim dhe që mos të miren ndërmjetësues mes Allahut, subhanehu ve teala, dhe mes robërve të Tij: “E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua”. [El-Bekare: 186]

Po ashtu edhe Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, kur i është thënë çka don Allahu dhe ti, tha Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem: “Më bëre ortak me Allahun, subhanehu ve teala! Thuaj: Çka don vetëm Allahu”, ngase “dhe” aludon barazim kurse Allahu, subhanehu ve teala, është veçuar me njëshmëri (uluhijet) duhet të veçohet me adhurim, e mos të barazohet me askënd prej krijesave në kërkimin e dobisë dhe largimin e dëmit.

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thotë: “Kujdesu për fenë e Allahut, Allahu do të kujdeset për ty. Kujdesu për fenë e Allahut, Allahun do ta gjesh para teje. Kur të kërkosk kërko prej Allahut. Nëse kërkon ndihmë kërko prej Allahut. Dije sikur tërë populli të tubohej që të ndihmoj me diç nuk do të ndihmonin, përveç atë çka e ka caktuar Allahu”.

Hoxha i nderuar, Ibën Tejmie, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Pasi që e di besimtari se Allahu, subhanehu ve teala, është Zot i çdo sendi dhe pronar i saj, ai nuk i përgënjeshton shkaqet që i krijoi Allahu, ashtu siç e bëri shiun shkak për ringjallje dhe kultivim. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: **“Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhapë në te nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argumente”**. [El-Bekare: 164]

Po ashtu siç e bëri Diellin dhe hënën shkak për atë çka krijon (kultivohen), gjithashtu ndërmjetësimi dhe lutja janë shkak për atë send çka janë bërë p.sh. namazi i muslimanëve mbi xhenazen është shkak me të cilin Allahu e mëshiron robin dhe i shpërblen falësit e këtij namazi”.

Por, duhet të dimë për shkaqet.

1. Shkaku vetjak, nuk pamëvarsohet, por duhet me këtë të ketë edhe shkaqe tjera, nga kjo kuptojmë se ka edhe pengesa nëse Allahu nuk i kompletton shkaqet, dhe i largon pengesat atëherë nuk do të arrihet qëllimi. Çka don Allahu, subhanehu ve teala, bëhet dhe pse njerëzit nuk dëshirojnë, dhe çka dëshirojnë njerëzit nuk realizohet vetëm se çka don Allahu.

2. Nuk lejohet të besohet se ndonjë gjë është shkak vetëm se me dituri, kush konfirmon ndonjë gjë se është shkak me padituri, apo është në kundërshtim me fenë islame ky kusht është i kotë, sikur që dikush mendon se të zotuarit është shkak për të larguar ndonjë dëm apo për të fituar dhe arritur ndonjë mirësi. Transmetohet nga Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, se e ka

ndaluar të zotuarit (angazhim me anë të betimit) duke thënë ai betim nuk sjell dobi në vepra, ai thjeshtë bën që personi i varfër të shpenzojë

3. Prej çështjeve të fesë asgjë nuk guxon të muret si shkak vetëm nëse janë prej Islamit legjislativ, ngase në çështjet e adhurimit duhet të ndalemi (abstenojmë). Nuk i lejohet njeriut t'i bëj ortak Allahut duke lutur dikë tjetër edhe nëse mendon se ky është shkak për të fituar disa gjëra personale. Për këtë nuk adhurohet Allahu me bidate të cilat janë në kundërshtim me fenë edhe nëse mendon se është mirë për të. Ndodhë që shejtanët ta ndihmojnë njeriun në disa qëllime të tij nëse i bën Allahut shok, ortak, ndodh që njeriu mund të arrij me kufër dhe mëkate disa qëllime të tij megjithatë nuk i lejohet kjo. Ngase dëmi i kësaj është më i madh se dobia të cilën e fiton. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, u dërgua për të arritur në dobitë dhe kompletuar, dhe për ta asgjësuar dëmin dhe zvogëluar. Atë të cilën e ka urdhëruar Allahu është dobi dhe çka e ka ndaluar (dëmi) është dëm.

Mushrikët në kohët e lashta dhe kohës sonë kanë rënë në shirk të madh duke u ngjitur në bishtin (bazuar) e ndërmjetësimit ashtu siç e ka cekur Allahu, subhanehu ve teala, në librin e Tij. Ndërmjetësimin të cilin mushrikët (idhujtarët) mendojnë se do të kenë dobi Ditën e Gjykimit nuk do të ekzistojë ashtu siç e ka asgjësuar dhe e ka quajtur të kotë Kur'ani në disa ajete të tij:

“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson Allahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. Allahu është dëgjues i dijshtëm”. [El-Bekare: 254]

Gjithashtu thotë: **“Ti tërhiqju vërejtjen me këtë (Kur'an) atyre që i frikësohen tubimit para Zotit të tyre, në mënyrë që të ruhen, sepse pos Tij nuk do të ketë as mbrojtës as ndërmjetës”.** [El-En'am: 51]

Këtë shefat të cilën e shfuqizoi dhe zhvlerësoi Kur'ani është ajo e cila kërkohet prej jo Allahut, subhanehu ve teala, ngase Allahu, subhanehu ve teala, e ka cekur ndërmjetësimin në disa ajete të librit të Tij të shenjtë. Allahu,

subhanehu ve teala, thotë: “Allahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotja as gjumë, gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij, e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen, nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar, Kursija e Tij (dija-sundimi) përfshijnë qiejt dhe tokën. Kujdesi i Tij ndaj të dyjave, nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi”. [El-Bekare: 255]

Gjithashtu thotë: “Thuaj: ‘I tërë shefaati (ndërmjetësimi) i takon vetëm Allahut, i Tij është pushteti i qiejve dhe i tokës, e më vonë vetëm te Ai ktheheni”.

[Zumer: 44]

Gjithashtu thotë: “E sa engjëj ka që janë në qiej, e që ndërmjetësimi i tyre nuk bën dobi asgjë, vetëm pasi që Allahu të japë leje për atë që dëshiron dhe që është i kënaqur për të”. [En-Nexhëm: 26]

Nga kjo që e cekëm aludon se shefati (ndërmjetësimi) është dy lloj:

1. Ndërmjetësimi i shfuqizuar dhe i zhvlerësuar (jo valid) ajo e cila kërkohet prej jo Allahut.
2. Shefati (ndërmjetësim) i konfirmuar (valid) ajo e cila kërkohet prej Allahut dhe është e veçantë vetëm për pasuesit e teuhidit të njëshmërisë dhe singëritetit, dhe pas kësaj është e kushtëzuar me dy kushte.
 1. T’ia lejojë Allahu ndërmjetësimin ashtu siç Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “Allahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotja as gjumë, gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij, e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen, nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar, Kursija e Tij (dija-sundimi) përfshijnë qiejt dhe tokën. Kujdesi i Tij ndaj të dyjave, nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi”. [El-Bekare: 255]
 2. Të jetë Allahu i kënaqur për të ndërmjetësuarin.

“Ai (Allahu) e di çka vepruan më parë dhe çka do të veprojnë, dhe ata nuk përpigën të ndihmojnë pos për atë me të cilin është i kënaqur Ai, e ata nga frika prej tij janë të kujdesshëm”. [El-Enbija: 28]

Negacioni i tretë

Shejhu i nderuar, Allahu e mëshiroftë, thotë: **Kush nuk i anatamos idhujtarët apo dyshon në kufrin e tyre, apo ua afirmon konfirmon fenë e tyre.**

Të tillët Allahu i anatamosi i quajti jobesimtar në shumë citate të Kur’anit, urdhëroi të armiqësohen për shkak të trillimeve, shpifjeve ndaj Allahut dhe për bërjen ortak me Allahun, pretendimi se Zoti ka fëmijë, Allahu është i Lartësuar nga kjo që thonë.

Allahu ua obligoi muslimanëve armiqësimin dhe urrejtjen ndaj kafirave. Nuk gjykohet për një person se është musliman derisa t’i anatamos (t’i nxjerrë prej feje idhujtarët) e nëse nuk i anatamos është indiferent pasi që t’i qartësohet gjendja, apo dyshon në kufrin e tyre pasi t’i tregohet atëherë ai është kafir si ata, kurse ai i cili e konfirmon, afirmon fenë e tyre dhe zbukuron gjendjen e tyre prej kufrit dhe mëkateve ky është kafir me pajtimin e gjithë dijetarëve. I tilli si ky nuk e kupton realitetin e Islamit i cili është të njehsohet Allahu, subhanehu ve teala, të nënshtruarit me adhurim dhe distancomi prej shirkut dhe pasuesve të tij; ky i gjori i miqësoi kafirat e jo t’i anatamos. Transmeton Muslimi se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: **“Kush dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut dhe përgënjeshton atë çka adhurohet krahas Allahut bëhet haram gjaku i tij dhe pasuria, kurse llogaria e tij është tek Allahu”.**

Nuk mjafton për mbrojtjen e gjakut të muslimanit të thotë- **“La ilahe ilallah”**, por patjetër duhet t’ia bashkëngjit kësaj përgënjeshttrimin e asaj çka adhurohet krahas Allahut e nëse nuk e përgënjeshton atëherë nuk i ndalohejt gjaku dhe pasuria e tij, por shpata e mprehtë është mbi të për humbjen dhe anashkalimit e një thelbi prej thelbeve të fesë së Ibrahimit për të cilin jemi urdhëruar ta ndjekim dhe të ecim në metodologjinë e tij duke mos u larguar dhe shtrembëruar për shkak të epshit të armiqve.

“Ju e keni shembullin më të mirë të Ibrahimit dhe të atë që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: ‘Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që adhuron, pos Allahut, nuk besojmë tuajën, prandaj ndërmjet nesh e jush është e hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm Allahun, Një!’ (Nuk e keni shembull) Me përjashtim të fjalës së Ibrahimit thënë babait të vet: ‘Unë do të kërkoj falje për ty, po unë nuk kam në dorë asgjë për ty të Allahu!’. Zoti ynë, vetëm Ty të jemi mbështetur, vetëm nga Ti jemi të kthyer dhe vetëm te Ti është e ardhmja! [Mumtehineh: 4]

Kjo është fe e Ibrahimit, kush largohet nga kjo vetëm se e ka humbur veten dhe është lajthitur.

“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson Allahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. Allahu është dëgjues i dijshtëm”. [El-Bekare: 256]

Shejh Muhamed ibën Abdulvehabi thotë: “Mënyra e të përgënjeshtërimit të tagutit bëhet, të besosh se adhurimi i diçkajit krahas Allahut është e kotë, të distancohesh nga taguti, ta urresh tagutin, të anatamosësh pasuesit e tagutit dhe të luftosh (armiqësosh) pasuesit e tagutit”.

Me këtë shpjegim të bëhet e qartë ty se gjendja e shumë kryetarëve të shteteve të cilët emërtohen si shtete islame, të tillët i miqësojnë idhujtarët, i ofrojnë, i madhërojnë dhe ngritin lidhje me të cilën e tregojnë se janë vëllezër të tyre e në të kundërtën i luftojnë pasuesit e fesë, i dënojnë dhe i fusin në burgje vallë A MBET ISLAM PAS GJITHË KËSAJ?!

Allahu i lartëmadhëruar thotë: “O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë, e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar”. [Maide: 51]

Gjithashtu thotë: “Besimtarët të mos i miqësojnë mosbesimtarët, e t’i lënë manash besimtarët. E kush bën atë, ai nga feja e Allahut nuk ka asgjë, përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre. Allahu ua tërheq vërejtjen

me dënim prej Tij, pse vetëm tek Allahu është e ardhmja". [Ali Imran: 28]

Obligohet për çdo musliman i cili e ka për fe Islamin t'i anatamos idhujtarët, t'i armiqësojë, t'i urrejë, t'i urrejë ata çka i duan idhujtarët apo polemizojnë, debatojnë në favor të tyre, shpërngulen tek ata pa asnjëfarë arsye fetare me të cilën është i kënaqur Allahu dhe Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem. Duhet muslimanët t'i kthehen fesë së tyre ngase me këtë arrihet krenaria dhe autoriteti, me këtë arrihet fitore, me Islam do të përparojë shteti, me këtë arrihet dallimi mes miqve të Allahut të cilët e ndihmojnë këtë fe dhe miqve të shejtanit të cilët nuk interesohen aspak se çka po i ndodhë fesë islame nëse janë të sigurt pasuria dhe ushqimi e tyre.

Muslimanët duhet ta kenë shembëlltyrë Ibrahimin, alejhi selam.

"Përveç Atij që më krijoi, dhe që Ai do të më drejtojë!". [Zuhruf: 27]

Ne muslimanët obligohemi t'i rikthehemi besimit tonë, fesë sonë dhe të praktikojmë fjalën e Allahut mbi kafirat: **"O ju që besuat! Luftoni jobesimtarët që i keni afër jush, e le ta ndiejnë prej jush grushtin e fortë kundër tyre. E dijeni se Allahu është me të devotshmit. E kur të kalojnë muajt e shenjtë, luftoni idhujtarët kudo që t'i gjeni, robëroni dhe ngujoni ata, e vinju pritë në çdo shteg. Në qoftë se pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë ua lëshoni rrugën, se vërtet Allahu falë është mëshirues".** [Teube: 123-125]

Çdoherë kur të distancohen njerëzit nga të gjykuarit me Kur'an dhe Sunet, Allahu do t'i sprovtojë me armikun e tyre. Kur shumica e kryetarëve të shteteve u larguan, distancuan nga të gjykuarit me Ligjin e Allahut dhe i aprovuan (kënaqen) ligjet e mallkuara njerëzore, dhe i mallkuar qoftë kush gjykohet te këta ligje, u nënçmuan dhe u shkatërruan shtetet e tyre. Ua shijoi armiku dënimet e dhimbshme prej nga nuk e pritnin.

Shumica e kryetarëve nuk ju intereson dhe nuk kujdesen vetëm se për pozitën e tyre e aspak nuk brengosen dhe mërzhiten a ngritet dhe krenohet feja a jo. Krenaria dhe autoriteti nuk arrihet vetëm nëse e ndihmojmë këtë fe. Është

obligim për çdo musliman i cili ka mundësi ta ndihmoj këtë fe, por shumica nuk e kuptojnë këtë.

Shkak (për mosinteresim) për gjithë këtë janë këshilltarët e çoroditur dhe anashkalimi i shumë thirrësve në këtë objektivë. Le ta dijë çdo musliman se kafirat nxitojnë, orvaten dhe kujdesen në çdo kohë për t'i larguar muslimanët nga feja e tyre. Nëse nuk zgjohet prej gjumit muslimani i cili kujdeset për fenë e tij do të vjen dita që do t'i kafshojë gishtat e tij prej pendimit, e do ta marr shpërblimin dhe frytin e fjalës popullore: "Kush nuk sulmon – sulmohet dhe kush nuk lufton – luftohet". Obligohet çdo dijetar thirrës, ligjërues hatib, imam i xhamisë t'ju tregojë njerëzve dëmet dhe rreziqet e miqësisimit të kafirave me argumentet e Sherijatit prej Kur'anit dhe Sunetit. E gjithë kjo tregon rrezikun e të shkuarit në shtetin e tyre apo t'i sjellin kafirat në shtetin e muslimanëve, ngase Allahu i këputi miqësimin dhe lidhjet mes muslimanëve dhe kafirave edhe nëse është më i afërt: **"O ju që besuat, mos u ofroni miqësi (dashuri) prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesimin kundër besimit. E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë"**. [Tevbe: 23]

Gjithashtu thotë: **"Nuk gjen popull që e beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit, e ta dojë atë që e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë që në zemrat e tyre (Ai) ka skalitur besimin dhe e ka forcuar me shpirt nga ana e Tij dhe ata do t'i shpjerrë në xhenete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Aty janë, përgjithmonë. Allahu ua ka pëlqyer punën e tyre dhe ata janë të kënaqur me shpërblimin e Tij. Të tillët janë palë (grup, parti) e Allahut, ta dini pra, se ithtarët e Allahut janë ata të shpëtuarit"**.

[Muxhadele: 22]

Gjithashtu thotë: **"O ju që besuat, nëse keni dalë (prej vendlindjes) për hir të luftës për rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush, mos e zini mik armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri, kur**

dihet se ata mohuan të vërtetën që u erdhi juve. Ata e dëbojnë të dërguarin dhe ju, sepse i besoni Allahut, Zotit tuaj, e ju fshehurazi u ofroni miqësi, po Unë më së miri e di atë që e keni fshehur dhe atë që e keni publikuar. Ai që punon ashtu nga pala juaj, ai e ka humbur rrugën e drejtë”. [Mumtehine: 1]

Për këtë Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë në hadithin të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi prej Usames: “Nuk trashëgon muslimani kafirat e as kafirat muslimanin”. Që mos të ndodh të ketë mes muslimanit e kafirit miqësim për këtë ndërpreu Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, trashëgimin. Transmetohet nga Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, se ka thënë: **“Nuk mbytet muslimani për kafir”**. Ngase kafiri është i nënçmuar dhe i pavlerë e si të mos jetë, kur Allahu, subhanehu ve teala, ka thënë: **“O ju që besuat, vërtet idhujtarët janë të ndyrë, andaj pas këtij viti të mos i afrohen më xhamisë së shenjtë. Nëse i frikësoheni skamjes, Allahu me dëshirën e vet do t’ju pasurojë me mirësitë e Tij. Allahu është i gjithëdijshtëm, është i urtë”**. [Tevbe: 28]

Le ta dijë çdo musliman se kafirat (prej çifutëve dhe krishterëve) e tjerë nuk do të dakordohen me muslimanët dhe nuk do të ketë marrëveshje dhe paqe e as që do të kënaqen me ta derisa muslimanët të ndjekin fenë e tyre dhe të shkojnë pas hapave të tyre siç Allahu, subhanehu ve teala, ka thënë: **“As jehuditë, e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri sa ta pasosh fenë e tyre. Thuaju. Udhëzimi i Allahut është udhëzim i drejtë. E nëse pasi që të ka ardhur ty e vërteta shkon pas mendimeve të tyre, nuk ka kush të ndihmojë e as të mbrojë nga Allahu”**. [El-Bekare: 120]

Ky është kërcënim i ashpër dhe i rreptë prej Allahut për atë i cili i ndjekë kafirat dhe se ky nuk do të ketë ndihmës dhe as mbrojtës. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka urdhëruar të distancohemi nga kafirat që mos të bëhemi prej tyre, dhe e bëri këtë çështje të madhe dhe tha: **“Unë distancohem**

prej çdo muslimani i cili jeton në mesin e idhujtarëve”.

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: **“Nuk e pranon Allahu nga idhujtari veprën pasi që të bëhet musliman derisa të distancohet prej kafirave”**. [Transmeton Nesaiu: Hadith Hasen]

Ankohemi tek Allahu, subhanehu ve teala, për këtë fe e cila është bërë e panjohur dhe ndryshimin e gjendjes së muslimanëve. Këta edhe pse po i dëgjojnë këto citate të qarta dhe të frikshme po shkojnë tek shtetet e tyre, bashkëpunojnë, hanë dhe pinë e qeshen me ta. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: **“Kush jeton me idhujtarët dhe banon me ta ai është si ata”**. Ku është feja e Ibrahimit, alejhi selam?! Ku është dashuria dhe urrejtja për Allahun, e tërë kjo, ndërsa shumicën e njerëzve i vëren të mos interesohen aspak!

Thënia e hoxhës “e afirmon, konfirmon fenë e tyre”, nën këtë futen shumica e njerëzve të cilët thërrasin në socializëm, sekularizëm, Baathie, demokraci (partinë në shtetet arabe) të gjitha këto janë grupe të humbura kafira edhe pse pasuesit e këtyre emërtohen me emra islamë. Emërtimi nuk ndryshon asgjë nga realiteti. Ankohemi tek Allahu çka na goditi në këto kohëra, janë ndryshuar peshoret, shumica filluan të bashkëpunojnë me emra e jo me realitete e me pretendime pa argumente. Armiqtë e Allahut të cilët e luftojnë këtë fe ditën e natën, haptas dhe fshehtas janë bërë besimtarë të sinqertë tek injorantët, neglizhentët dhe pasuesit e epshit me pretendim dhe argument se dëshmojnë La ilahe ilallah. E çka i bën dobi kjo fjalë kur është bërë ushtar prej ushtarëve të iblisit (shejtanit) dhe armik i përbetuar i kësaj feje me shpirt dhe pasuri.

Negacioni i katërt

Shejh Muhamed ibën Abdulvehabi, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Të besuarit në udhëzimin e tjetërkujt krahas udhëzimit të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, se është më i kompletuar dhe se gjykimi (ligji) i tjetërkujt është më i mirë se Gjykimi (Ligji) i Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, si dhe ai i cili i jep përparësi gjykimit të tagutit para gjykimit të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem”.

Çështja e parë, e ajo është **“Të besuarit se udhëzimi i tjetërkujt krahas udhëzimit të Pejgamberit është më i kompletuar”**

Kjo çështje është një çështje e madhe dhe e rrezikshme, ngase të besuarit në këtë mënyrë të shpien në Xhehenem dhe se është në kundërshtim me citate të vërteta.

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thoshte në hutben e xhumasë: “Fjala më e mirë është fjala e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamdeit, salallahu alejhi ve selem”. S’ka dyshim se udhëzimi i Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, është më i përsosur, ngase është shpallje siç Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Ai (Kur’ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet”. [En-Nexhëm: 4]

Janë pajtuar të gjithë dijetarët islamë se baza e dytë prej bazave të Sherijatit islam është Suneti dhe se është i pavarur në gjykim dhe ligjdhënie njëlloj si Kur’ani në lejim dhe ndalim. Transmetohet se i ka thënë Omerit...

Ligji islam është dirigjues i të gjitha feve tjera, gjithashtu është feja më e lehtë dhe më praktike. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: **“Feja më e dashur tek Allahu është Islami”.**

Pas gjithë kësaj, si mund të jetë udhëzimi i tjetërkujt më i kompletuar dhe i

përsosur se udhëzimi i Pejgamberit?!

Transmetohet se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: **“Betohem në Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, po të ishte Musai në mesin tuaj dhe ju ta pasonit e të më linit mua, do të humbnit dhe lajthitmit”.**

Allahu, subhanehu ve teala, e ngriti këtë umet ngase ua kompletoi fenë dhe ua plotësoi mirësitë e gjithë kjo ndodhi me anë të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem: **“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe”.** [El-Maide: 3]

Gjithashtu thotë: **“Me atë të cilën Allahu është i kënaqur me ne, dhe ne jemi të kënaqur, ngase është feja të cilën e don, gjithashtu është i kënaqur me këtë fe me të cilën i dërgoj pejgamberët”** [Ali Imran: 19-85]

Çështja e dytë: **Besimi se gjykimi (ligji) i tjetërkujt është më i mirë se Gjykimi (Ligji) i Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, si dhe ai i cili i jep përparësi gjykimit të tagutit para gjykimit të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem.**

Atëherë ky është kafir me pajtimin e të gjithë dijetarëve. Gjithashtu futen në këtë lloj (kafirave) edhe ata të cilët i preferojnë ligjet e tagutave njerëzore para gjykimeve të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, ngase të tillët i dhanë përparësi ligjeve njerëzore para ligjit të Pejgamberit të cilin e dërgoi Allahu udhëzues për njerëzimin dhe për t'i nxjerrë prej errësirës në dritë:

“Elif, Lam, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t'i nxjerrish njerëzit prej errësirave në dritë; (t'i nxjerrish prej errësirës) në rrugë të Fuqiplotit, të Falënderuarit”. [Ibrahim: 1]

Duhet ta di çdo musliman dhe muslimane se Ligji i Allahut dhe i Pejgamberit është prirës para çdo ligji tjetër. Nuk ka çështje e cila ndodh në mes njerëzve vetëm se ka zgjidhje në Ligjin e Allahut dhe Pejgamberit.

Kush gjykohet me ligje tjera pos Ligjit të Allahut është kafir ashtu siç është

theksohet në Kur'an: "A i vure re ata që mendojnë se besuan atë që të zbriti ty, dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë që mes tyre të gjykojë djalli, e duke qenë se janë të urdhëruar që të mos e besojnë atë. E djalli dëshiron t'i humbë në pafundësi. Kur u thuhet atyre: "Ejani (për të gjykuar) te ajo që e zbriti Allahu dhe te i dërguari!" i sheh se si dyfytirëshit ta kthejnë shpinën. E qysh do të jetë (gjendja e tyre) kur t'i godasë ata ndonjë e keqe, e shkaktohet nga vetë duart e tyre, e pastaj vinë te ti (për t'u arsyetuar) dhe betohen në Allahun. "Ne nuk patëm tjetër qëllim, vetëm afrim e pajtim" (e jo refuzimin e gjykimit Tënd). Ata janë për të cilët e di Allahu eka mbajnë në zemrat e tyre. Po, ti hiq ty, tërhiq vërejtjen (për hipokrizi) dhe thuaju fjalë që lënë përshtypje në veten e tyre. Ne nuk dërguam asnjë të dërguar vetëm që me urdhërin e Allahut t'i bëhet respekt (nga njerëzit) atij. E sikur të vinin ata te ti, pasi që ta kenë dëmtuar veten e tyre (nuk kanë pranuar gjykimin tënd), e të kërkonin ata vetë ndjesë te Allahu, e edhe i dërguari të kërkojë ndjesë për ta, ata do të kuptonin se Allahu pranon pendimin dhe është mëshirues. Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht". [Nisa: 60-65]

U betua Allahu, subhanehu ve teala, në veten e Tij se këto nuk besojnë derisa t'i plotësojnë tre elemente:

1. Ta marrim gjykues Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem, në çdo çështje.
2. Mos të ndjejmë pakënaqësi.
3. Ti dorëzohen gjykimit të tij dhe të binden.

Si kënaqet i mençuri të gjykohej me ligjet e krijesave, mendimet e të poshtërve në vend të Ligjit të Allahut të cilin e zbriti mbi të Dërguarin e Tij për t'i nxjerrur prej errësirës në dritë. Po ashtu ligjet njerëzore bazohen në padrejtësi dhe të marrin pasurinë me forcë (diktaturë). Shiko çka ndodhi me shumë shtete kur u distancuan, kur u larguan nga Ligji i Allahut dhe të Dërguarit të

Tij e u kënaqën me ligjet e krijesave. Padrejtësia është qëllimi i tyre. E kota dhe mëkatet janë të përhapura! Nuk ka kush të ndalojë nga e keqja, u rrit i vogli dhe u plak i moshuari, u ndryshua natyra e tyre, jetojnë jetë shtazarake, kështu jeton çdokush i cili distancohet nga Ligji i Allahut dhe i dërguari i tyre. Allahu te'ala thotë: **“Ne e zbritëm Tevratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij gjykuan ndaj atyre që ishin jehudi, pejgamberët që ishin të bindur, gjykuan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, ngase ishin të obliguar ta ruanin librin e Allahut dhe ishin mbrojtës të tij. Prandaj, mos u frikësoni nga njerëzit, vetëm Mua të më frikësoheni dhe mos i ndërroni argumentet e Mia për pak send. E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë mohues”**. [Maide: 44]

Shejh Islam Ibën Tejmie, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij **“El-Iktida”** thotë: Dallimi mes kufrit të shquar me **“Elif dhe Lam”** siç ceket në hadithin e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem: **“Nuk ekziston mes njeriut dhe kufrit e shirkut vetëm se lënia e namazit”**. Fjala kufër në trajtën e shquar në shumicën e rasteve nënkuptohet kufër i madh, si fjala e Allahut: **“Ata janë kafira** për ata të cilët gjykojnë me ligj tjetër pos Ligjit të Allahut”. Kurse sa i përket asaj që transmetohet nga Ibën Abasi se është kufër i vogël nuk është e konfirmuar prej tij”. Hishamin e kanë dobësuar Imam Ahmedi dhe Jahja. Gjithashtu (ky transmetim është në kundërshtim me) është kundërshtuar Hishami transmeton Abdu Rezaku në tefsirin e tij prej Mamerit, prej Tavusit e ky prej babait të tij se është pyetur Ibni Abasi për fjalën e Allahut, subhanehu ve tealat: **“Ne e zbritëm Tevratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij gjykuan ndaj atyre që ishin jehudi, pejgamberët që ishin të bindur, gjykuan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, ngase ishin të obliguar ta ruanin librin e Allahut dhe ishin mbrojtës të tij. Prandaj, mos u frikësoni nga njerëzit, vetëm Mua të më frikësoheni dhe mos i ndërroni argumentet e Mia për pak send. E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë mohues”**, ndërsa ky ka thënë se kjo është kufër, kjo është e njohur prej Ibni Abazit se ajeti

kuptohet ashtu si është. E kufri i cili është cekur në ajet është kufër që të nxjerr prej Islamit.

Vallë si të quhet një njeri musliman, ndërsa ai është larguar nga Islami dhe i ka përqaftuar ligjet çifute dhe krishtere?! Kjo edhe pse është ndryshimi i fesë po ashtu distancohesh nga kjo fe e pastër, ky është negacion tjetër. Kurse sa i përket komentimit të Ibën Abazit të cilin e transmeton Ibën Xheriri se nuk është kufër si mosbesimi në Allahun dhe Ditën e Gjykimit.

Nuk aludon se gjykimi me ligj tjetër është kufër i vogël. Ai i cili e kupton kështu duhet të sjell argumente për pretendimin e tij. Kuptohet nga fjala e tij se kufri ka shkallë, ndonjëra është më e keqe se tjetra, ngase kufri i mohimit të Allahut dhe melaqeve është më i keq se ai i cili gjykon me ligj tjetër pos Allahut. Gjithashtu edhe ne themi se kufri i gjykuesit me ligj tjetër pos Ligjit të Allahut është më i lehtë se kush e përgënjeshtrohet Allahun dhe melaqet. Nuk do të thotë kjo se gjykuesi është musliman dhe kufri i tij është i vogël. Jo, assesi, por ka dalur prej feje për distancimin dhe largimin e tij nga Ligji i Allahut. Ibën Kethiri ka thënë se ekziston ixhma (pajtim prej gjithë dijetarëve). Të gjykuarit me ligje të Allahut dhe të besuarit se gjykimi i Pejgamberit është më i mirë se çdo gjykim tjetër është prej bazave (kërkesave) të fjalës La ilahe ilallah. Kush pretendon se gjykimi i tjetërkujt është më i mirë se gjykimi i Pejgamberit ky nuk e din kuptimin e fjalës La ilahe ilallah, ngase të nënshtruarit është kusht prej kushteve të fjalës La ilahe ilallah. Me këtë fjalë u ngritën qiejt dhe toka, për këtë fjalë u obligua xhihadi, u dalluan njerëzit, të gëzuar dhe të poshtëruar. Ai i cili e kupton këtë fjalë dhe vepron duke i kompletuar kushtet dhe bazat, vetëm se është distancuar prej mosgjykimit me ligj tjetër pos Ligjit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Me të vërtetë është ndryshua gjendja veçanërisht në këtë kohë e cila i përgjan kohërave të plogështve. U distancuan prej fjalëve të Allahut, prej Ligjit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij duke i përqaftuar mendimet e çifutëve dhe të krishterëve, të cilët nuk shikojnë dhe praktikojnë konventa ndërkombëtare e

as ligje nëse flitet për diç kundër muslimanëve, dhe gjithashtu të kënaqurit me gjykime dhe mendime njerëzore.

Allahu e mëshiroftë **Ibën Kajimin** i cili thotë: “Nuk ju frikësohem mëkateve, ngase ekziston rruga e faljes, por frikësohem nga të larguarit e zemrës prej gjykimit sipas shpalljes së Kur’anit!”.

Ky negacion i kaplon edhe thëniet se të gurëzuarit e lavirit dhe lavires dhe prerja e dorës së vjedhësit nuk i përshtatet kohës sonë, ngase koha jonë është ndryshuar prej kohës së Pejgamberit apo se shtetet e huaja na nënçmojnë me këto gjeste. Ky felënës ka gjykuar se ligji i kësaj kohe është më i mirë se ligji i Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, dhe udhëzimit tij. Gjithashtu futet nën këtë ai i cili thotë se lejohet në këtë kohë të gjykohej me ligje tjetër pos Ligjit të Allahut.

Ky e lejoi një ndalesë që është ndaluar me pajtimin e të gjithë muslimanëve. Allahu është më i Dituri!

Negacioni i pestë

Imam Temimi, rahimehullah, thotë: “**Ai i cili urren diç prej asaj me të cilën ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, dhe nëse vepron me të, del nga Islami (bën kufër)**”.

Kjo është me pajtimin e të gjithë dijetarëve, siç thotë autori i librit “Ihnau” dhe të tjerët.

Të urrejturit e diç prej asaj që ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, prej fjalëve apo veprave është një lloj prej llojeve të nifakut (hipokrizisë) në besim, e cila e bën pronarin e saj të jetë në shtresën e fundit në zjarr.

Ai i cili urren diç prej asaj me të cilën ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, është në rrezik të madh.

Prej këtij lloji është ajo që e shkruajnë disa shkrimtarë ateistë të poshtëruar të cilët janë ushqyer me qumësht francez. Nxorën litarin e Islamit nga supet e

tyre me urrejtjen e poligamisë, ata e luftojnë poligaminë me çdo mjet. A nuk e dinë ata që me këtë e luftojnë Allahun dhe Pejgamberin e Tij dhe se me këtë ia kundërshtojnë (thyejnë) Allahut, subhanehu ve teala, urdhërin?!

E ngjashme me këta në kufër është urrejtja ndaj asaj me të cilën ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, të tillët janë ata që e urrejnë mosbarazimin e gruas me burrin në pozitë si p.sh. urrejnë që dija e gruas të jetë në gjysmë të dijës së burrit, dhe se dëshmia e dy grave është e barabartë me dëshminë e një burri etj.

Ata e urrejnë fjalën e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem: “Nuk kam parë më mendjelehta se ju (gratë), i shkon mendja burrit të vendosur prej ndonjëri prej ju...”.

Mu kështu i sheh se si i zgjasin gjuhët e tyre ndaj këtij hadithi të madh, me anë të largimit nga kuptimi i vërtetë i tij, apo duke e dobësuar atë me argumente se është në kundërshtim me mendjen, apo se rrethanat e refuzojnë këtë dhe punë të tjera të cilët na tregojnë dhe vërtetojnë urrejtjen e asaj me të cilën ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem.

Pra, ata janë kafira, po edhe nëse veprojnë me domethënien e tekstit, ata nuk i kanë plotësuar kushtet e fjalës (La ilahe ilallah), sepse prej kushteve të saj janë: të duash kuptimin e kësaj fjale dhe të kënaqesh me të, të hapësh gjoksin ndaj kësaj fjale. Ndërsa atyre ju shtrënguan gjokset dhe nuk u kënaqën, urrejnë domethënien e saj. Mu kjo është vepra e munafikëve të cilët veprojnë shumë prej çështjeve të ligjit Islam të dukshme për ndonjë qëllim të tyre, por gjithë këtë e bëjnë duke e urrejtur. Pikërisht për këtë thotë Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem: “Kush thotë La ilahe ilallah me sinqeritet prej zemrës së tij do të hyjë në Xhenet”. Pra, fjala e tij “me sinqeritet prej zemrës së tij” përjashtohet me këtë munafiku (hipokriti), sepse ai nuk e ka thënë me sinqeritet prej zemrës së tij, me të vërtetë e ka thënë që ta mbrojë me këtë gjakun dhe pasurinë e tij.

Thotë Allahu duke gjykuar me kufër mbi ata të cilët e urrejnë atë që i është zbritur Muhamedit, salallahu alejhi ve selem.

Pra, Allahu, subhanehu ve teala, ua shkatërroi veprat dhe i bëri hi e pluhur për shkak të urrejtjes së asaj që Ai, subhanehu ve teala, ia zbriti Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, prej Kur'anit të cilin e bëri fitues dhe shpëtues për ata që kapen për të, veprojnë urdhërat e Tij dhe ndalen nga ndalesat e Tij. Pra, secili që urren atë që ka zbritur Allahu, subhanehu ve teala, vepra e tij është e shkatërruar, edhe pse vepron me të, por ai e uren, siç thotë Allahu.

Kjo është prej çështjeve që më së shumti e frikëson besimtarin që të jetë urrejtës i asaj që i është zbritur Muhamedit, salallahu alejhi ve selem. Ka mundësi që kjo të fshehet në veten e tij dhe nuk mund që ta vërejë vetëm se pas një kohe të gjatë të jetës së tij. Pikërisht për këtë duhet të thuhet shpesh fjala (lutja) e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem: "O Rrotullues i zemrave, forcoma zemrën time në fenë tënde!", sepse zemrat janë në mes dy gishtave prej gishtave të Mëshiruesit, i rrotullon ashtu siç don Ai.

Prej çështjeve që duhet pasur kujdes gjithashtu është se shumicës prej njerëzve iu bëhet e qartë se një punë është e keqe, por refuzon që ta pranojë dhe atë që i thua, e veçanërisht pasi që ta bën atë të keqe. Këtij nuk i thuhet se urren atë me të cilën ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, në përgjithësi, por duhet ndarë, sepse ka mundësi që ai mos ta pranojë të vërtetën që t'i prezantohet për shkak të sjelljes tënde të keqe gjatë të urdhëruarit në të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja. Në qoftë se i vjen ndonjë tjetër përpos teje, dhe ia sqaron të njëjtën të keqe, do të pranonte dhe nënshtrohej. Apo ndoshta ai nuk pranon se ka ndonjë send në mes teje e tij, pra ky nuk quhet urrejtës i asaj me të cilën ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem.

Ka disa njerëz që mendojnë se ai i cili bën mëkat është urrejtës i asaj me të cilën ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem. Konkludon prej ruajtësit të mjekrës, lëshon petkun zhagaz, konsumon alkool etj. se e urren atë me të cilën ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, prej urdhërit për

lëshuarjen e mjekrës, moslëshuarjen e mjekrës, ndalesën e alkoolit, iu thotë atyre: “Ju po të mos e kishit urrejtur atë me të cilën Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, ka ardhur, nuk do të kishit bërë këto të këqija!”. Kjo konkluzë është e kotë dhe e pavërtetë, sepse kemi disa nga shokët e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, që kanë bërë disa kundërshtime siç është p.sh pirja e alkoolit por nuk konkludoi asnjëri prej shokëve të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, me këtë konkluzë, por kur u sjell një pirës i alkoolit tek Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, dhe e mallkuan disa prej shokëve të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, dhe thanë se sa shpesh që po bëhet i dehur ky. Ua ndaloi Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, mallkimin, dhe tha: **“Ai e don Allahun dhe të Dërguarin e Tij”**.

Të konkluduarit e tillë do të thotë se i nxjerrim veprimtarë e mëkateve të mëdha nga Islami, ndërsa kjo është në kundërshtim me besimin e Ehli Sunetit. Vepruesit e mëkateve janë nën dëshirën e Allahut, nëse don ua falë e nëse don i dënon sipas krimit që kanë bërë, ndërsa përfundimin e kanë në Xhenet, Allahu është më i dijshtëm!

Negacioni i gjashtë

Autori, Allahu e mëshiroftë, thotë: **“Ai i cili luan (tallet) me diç prej fesë së Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, me shpërblimin apo dënimin e tij, bën kufër (del nga feja)”**.

Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Thuaj: ‘A me Allahun, argumentet e Tij dhe të Dërguarin e Tij ishit duke luaj? Mos u arsyetoni vetëm se keni bërë kufër pasi që patët besuar”**. [Teube: 65-66]

Të tallurit me diç prej asaj me të cilën ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, është kufër me pajtimin e të gjithë muslimanëve, edhe nëse nuk e ka për qëllim realitetin e të tallurit.

Transmeton Taberiu, Ibën Hatimi, Ebu Shejhi etj. nga Abdullah ibën Omeri,

radijallahu anhu, i cili ka thënë: Tha një njeri në luftën e Tebukut. Nuk kemi parë si ata lexues të Kur'anit, janë ngrënës të mëdhenj, kanë gjuhë rrenacake, janë më frikacakë në luftë... Tha njëri prej mexhlisit: Gënjen, ti me të vërtetë je munafik, do t'i tregoj Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem!

Kuptoi për këtë Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ndërsa Allahu, salallahu alejhi ve selem, i shpalli ajete. Thotë Abdullahu: "Unë shihja se si ishte i varur pas fundit të devesë, ndërsa gurët e gjuanin, e ai thoshte: "O i Dërguari i Allahut ne me të vërtetë kalonim kohën duke bërë tallje", ndërsa Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thoshte: **"A me Allahun, argumentet e Tij dhe të Dërguarin e Tij bënit tallje"**.

Pra, fjala e tyre (ne me të vërtetë kalonim kohën duke bërë tallje) do të thotë, ne me të vërtetë nuk kishim për qëllim në të vërtetë talljen, por donim ta kalonim kohën dhe të lozim, t'i kalojmë lodhjet e rrugës. Siç ka ardhur në disa transmetime të hadithit, por megjithatë Allahu, subhanehu ve teala, i bëri kafira, ngase në këtë aspekt nuk lejohet tallja dhe loja. Ata u bënë kafira me këtë fjalë, edhe pse më parë ishin besimtarë. Ndërsa sa u përket atyre që thonë se ata kanë bërë kufër pas besimit me gjuhën e tyre duke bërë kufër më parë me zemrën e tyre, këtë fjalë e ka demantuar Shejhul Islam Ibën Tejmiu duke thënë: "Të besuarit me gjuhë me kufër të zemrës i është bashkëngjit kufër, nuk iu thuhet "Me të vërtetë keni bërë kufër pas imanit" ata kanë vazhduar të jenë kafira në të njëjtën çështje.

Kush bën tallje me diç prej asaj që ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, siç është të tallurit me diturinë e Sherijatit dhe pasuesit të saj për shkak të diturisë, të tallurit me shpërblimin dhe dënimin e Allahut, të tallurit me urdhëruesit në të mirë dhe të ndalurit nga e keqja për shkak të urdhëruarit në të dhe të ndaluarit në të, të tallurit me namazin qoftë nafie apo farz, gjithashtu të tallurit me falësit e namazit për shkak të namazit të tyre, të tallurit me ata që lëshojnë mjekrën për shkak mjekrës, të tallurit me atë që e lënë kamatën për shkak se e kanë lënë kamatën, ky njeri është kafir!

Të tallurit me diç prej asaj që ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem,

është prej cilësive të munafikëve, siç thotë Allahu, subhanehu ve teala:

“Mëkatarët ishin ata të cilët i përqeshnin ata që besuan. Dhe kur kalonin (besimtarët) pranë tyre (idhujtarëve), ata ia bënë me sy njëri tjetrit. E kur ktheheshin te familjet e veta, ktheheshin të kënaqur. Dhe kur i shihnin ata (besimtarët), thoshin: “S’ka dyshim se këta (besimtarët) janë të humbur!” Po Ne, nuk i caktuam ata (idhujtarët) si rojë të atyre (besimtarëve). E sot, (në ditën e gjykimit), ata që besuan do të tallen me jobesimtarët. Duke qëndruar të mbështetur (besimtarët) në kolltukë e duke shikuar. A thua a u shpërblyen jobesimtarët për atë që punuan? (Po)”. [Mutaфин: 29-36]

Shumica prej dijetarëve e kanë ndarë të tallurit me atë që i është shpallur Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, në dy lloje:

1.Të tallurit e qartë, siç është rasti i atyre për të cilët kanë zbritur këto ajete, e ajo është fjala e tyre (ne nuk kemi parë si ata lexues tanë të Kur’anit, të dhënë pas barqeve me gjuhë rrenacake, më frikacakë në luftë) apo fjalë të ngjashme të tallësve.

2.Të tallurit jo i qartë, kjo është një det pa bregdet, siç është të bërit shenjë me sy, të nxjerrit e gjuhës, zgjatja e buzës, të bërit me shenjë gjatë leximit të Kur’anit apo Sunetit të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, apo gjatë të urdhëruarit në të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja.

Është obligim për çdo musliman që t’i ndërpres lidhjet me ata që tallen me fenë e Allahut dhe me Sunetin e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, edhe nëse është njeriu më i afërt i tij, dhe mos të ulet me ata që mos të bëhet prej tyre, siç Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “Juve u është shpallur në librin (Kur’anin) që, kur të dëgjoni se po mohohet Kur’ani i Allahut dhe po bëhet tallje me të, mos rrini me ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe, ju do të jeni si ata. Allahu do t’i tubojë tradhtarët dhe jobesimtarët që të gjithë në xhehenem.” [En-Nisa: 140]

Pra, ai që i dëgjon ajetet e Allahut duke u tallur me to, ndërsa ai është duke qëndruar me ata duke u kënaqur me të ndenjurit me ta, ai është i njëjtë sikur

ata në mëkat, kufër, dhe dalje nga Islami, siç tha Allahu.

“Tuboni ata që ishin zullumqarë, shoqërinë e tyre dhe ata që i adhuruan”.

[Safat: 22]. Do të thotë të ngjashmit sikur ata.

Negacioni i shtatë

Autori, Allahu e mëshiroftë, thotë: **“Sihri (magjia), e prej saj është edhe sarfi dhe atfi, kush e bën apo kënaqet me të, bën kufër, argument për këtë është fjala e Allahut. “(E hodhën librin e Zotit) E ndoqën atë që e thonin djajt në kohën e sundimit të Sulejmanit. Po Sulejmani nuk ishte i pafe, por djajt ishin të pafe, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (Ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t’i thonin: “Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pafe!” E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejen e Allahut me atë askujt nuk mund t’i bënë dëm dhe ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (jehuditë) e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata se për çka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe”.** [El-Bekareh: 102]

Sihër në gjuhën arabe i thuhet sendit që fshihet, nuk dihet prej nga vjen dhe është preciz.

Prej këtij lloji është edhe fjala e arabëve për ndonjë gjë të fshehur mirë – “më e fshehtë se sihri”.

Definicioni i saj në Sherijat është: “Nyje dhe fryrje të magjistarit me të cilat arrin që t’i shfrytëzon shejtanët që t’i bëjë dëm të bërit magji prej njerëzve”. Përpos këtij definicioni kemi edhe tjerë.

Shenkiti, rahimehullah, thotë: “Dije se sihri nuk mund të definohet me një definicion përmbljedhës-pengues, sepse ka shumë lloje që hynë në të, e me këtë nuk ka mundësi të përmblidhen të gjithë me një definicion që i kaplon e mos të kesh ndonjë tjetër. Pikërisht për këtë dijetarët nuk janë të pajtimit gjatë definimit të tij, dhe kanë dallime të qarta”.

Prej llojeve të sihrit janë edhe **sarfi** dhe **atfi**.

Sarf do të thotë: të largosh njeriun nga ajo që don ai, si p.sh. ta largosh nga të dashurit e bashkëshortes së tij në urrejtjen e saj.

Atfi është vepër e sihrit sikur sarfi, por e bën njeriun ta don atë të cilin nuk e don (e urren), me anën e shejtanëve. Sihri është i ndaluar në të gjitha ligjet e pejgamberëve.

Kaptina e sihrit

Me sihrin kanë të bëjnë disa çështje, do të përmendim bashkë me disa prej fjalëve të dijetarëve, për shkak të rëndësisë së kësaj kaptine, dhe shpërndarjes së tij në shumicën e vendeve në botë.

Çështja e parë: A është sihri i (realitet) vërtetë?

Na argumenton fjala e Allahut: **“Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja”**. [Felek: 4]

Ngase sihri është (realitet) i vërtetë, përndryshe nuk do të na urdhëronte Allahu, subhanehu ve teala, që të kërkojmë mbrojtje për këtë.

Gjithashtu fjala e Allahut: **“(E hodhën librin e Zotit) E ndoqën atë që e thonin djajt në kohën e sundimit të Sulejmanit. Po Sulejmani nuk ishte i pafé, djajt ishin të pafé, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (ndiqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t’i thonin: “Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pa fé!” E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejën e Allahut me atë askujt nuk mund t’i bënë dëm dhe ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (jehuditë) e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata se për ç’ka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe”** [El-Bekare: 102]

Ky ajet na argumenton se sihri ka vërtetësi që bëhet shkak i ndarjes së burrit prej gruas. Prej argumenteve është edhe hadithi i Aishes, radijallahu anha, se

Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, i tha një ditë. ju bë sihër, derisa i dukej se bënte një vepër, por ai në realitet nuk e bënte. Asaj (Aishes) i tha: Më erdhën dy melekë, mu ul njëri tek koka, ndërsa tjetri tek këmbët dhe tha: Ç'far dhimbe ka njeriu? U përgjigj: I është bërë sihër. Tha: Kush i ka bërë sihër? U përgjigj: Lebid ibën El-Easami i ka bërë sihër në qime të flokës dhe mjekrës në brendësinë e një hurme".

Ky mendim është mendimi i Ehli Sunnetit dhe shumicës prej dijetarëve islamë. Mendimi i disa të tjerëve është se sihri nuk ka vërtetësi, ky është mendimi i mu'tezilive të larguar nga Kur'ani dhe Sunneti. Këtë e kanë argumentuar me fjalën e Allahut, subhanehu ve teala: **"Ai (Musa) tha. Jo, hidhni ju! Kur, ja, atij iu duk se nga ajo magji e tyre litarët dhe shkopinjtë lëviznin (si gjarpërinj)".**

[Taha: 66]

Pra, nuk tha se në të vërtetë lëvizin, dhe thonë se sihri është supozim dhe ëndërr dhe se nuk është i vërtetë, se është një lloj bestytanie.

Ibën Kajimi, rahimehullah, thotë: "Ky mendim është në kundërshtim me mendimin unanim të sahabëve dhe selefite (të parëve tanë), gjithashtu edhe me pajtimin e fukahave, komentatorëve të Kur'anit, transmetuesve të hadithit, dhe pronarët e zemrave të shëndosha nga ibadetçinjtë. Është në kundërshtim me shumicën e njerëzve të mençur. Sihri i cili ndikon duke e sëmure njeriun, rënduar, zgjidhur e lidhur, dashuruar, urretur, duke zbukuruar gjërat, dhe shenja tjera të cilat i dinë të mençurit nga shumica e njerëzve".

Kurtubiu, rahimehullah, pasi që përmend mendimin e mu'tezilive dhe argumentin e tyre thotë: "Në këtë nuk ka argument, sepse ne nuk mendojmë që të ëndërruarit mund të jetë prej sihrit, por më shumë se kjo, kemi vepra që tejkalojnë mendjen, por ka ardhur Sherijati me to. Prej këtij lloji është të përmendurit e sihrit dhe të mësuarit e tij". Ka për qëllim fjalën e Allahut, subhanehu ve teala: – [Bekare 102] që përmendëm më sipër.

Po të mos kishte sihri vërtetësi (realitet), nuk do të mund të mësohej e as nuk do të na lajmëronte Allahu, subhanehu ve teala, se mund t'iu mësohet njerëzve, pra kjo na argumenton se sihri ka vërtetësi. Gjithashtu fjala e

Allahut: “Ai (Musai) tha: “Hidhni ju”! E kur hodhën ata (shkopinj e litarë), magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe sollën një magji të madhe”. [El-Araf: 116]

Sureja Felek ka zbritur për shkak të sihrit të bërë nga ana e Ledid ibën El-Easam me pajtimin e të gjithë komentatorëve të Kur’anit. Pastaj e ceku hadithin të cilin e cekëm, dhe mëpastaj tha: Në këtë hadith është fjala e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, kur u lirua nga sihri dhe Allahu, subhanehu ve teala, më shëroi, ndërsa shërimi bëhet me largimin e sëmundjes, pra kjo është argument se sihri ka vërtetësi (realitet). Ky është lajm i prerë me lajmërimin e Allahut dhe Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, për ekzistimin e tij. Të këtij mendimi janë të gjithë ata (që iu mirret) me të cilët vendoset koncenzi, ndërsa fjala e mu’tezilive nuk mirret parasysh në kundërshtimin ndaj pasuesve të së vërtetës.

Çështja e dytë: Dispozita ndaj magjistarit.

Dijetarët kanë polemikë rreth magjistarit a bën kufër (del prej Islami) apo jo. Mendimi i autorit të librit është se bën kufër për shkak të fjalës së Allahut, subhanehu ve teala: – [Bekare 102]

Ky është mendimi i Imam Ahmedit, rahimehullah, Malikut, Ebu Hanifes dhe shumicës së dijetarëve.

Ndërsa mendimi i Shafiut është se nëse e mëson magjinë, i thuhet atij, na përshkruaj neve magjinë tënde. Nëse na përshkruan me diç që është kufër, siç është sihri i babilonasve që i adhurojnë yjet, dhe veprojnë atë që kërkojnë nga ata, ky pra është kafir. E nëse nuk arrin deri në kufër, por beson se ky haram është hallall, në këtë rast nuk bën kufër.

Shenkiti, rahimehullah, thotë: “Më e vërteta në këtë çështje është se nëse është magjia prej llojit që madhërohet dikush tjetër përpos Allahut, subhanehu ve teala, p.sh. yjet, xhinët e tjerë, gjë kjo e cila të dërgon në kufër, është kufër pa dyshim. Prej këtij lloji është magjia e Harutit dhe Marutit e cekur në suren

Bekare, është kufër pa polemikë siç argumenton edhe fjala e Allahut, subhanehu ve teala: – [Bekare 102]

Dhe fjala e Tij:

Në qoftë se sihri është kufër siç është të kërkuarit ndihmë nga disa njerëz të veçantë duke iu bërë ujdë e tjerë kjo është haram i madh, porse nuk arrin vepruesi i saj deri në kufër (dalje nga Islami).

Kjo ishte e vërteta rreth kësaj çështjeje, në të cilën kanë polemikë dijetarët. Dije se magjistani duhet mbytur në të dy rastet, ky është mendimi i vërtetë i dijetarëve, ngase ai është prishës në tokë, ndan burrin prej gruas. Të mbeturit e tij në sipërfaqen e tokës është rrezik i madh për njerëzit dhe shoqërinë. Ndërsa me mbytjen e tij këpusim fesadin, trazirat, i rehatojmë robërit e Allahut, pastrojmë tokën prej fëlliqësirave. Në vijim do të pasojë diç mbi unanimitetin e sahabëve për mbytjen e magjistarit.

Çështja e tretë: Mbi mbytjen e magjistarit dhe magjistares.

Dijetarët janë të ndarë përkitazi në këtë çështje në dy mendime.

Mendimi i parë. Është mendimi i shumicës se duhet të mbytet. Ky është mendimi i Imam Malikut dhe Ahmedit.

Mendimi i dytë. Nuk mbytet, vetëm atëherë kur të veprojë vepër të kufrit. Ky është mendimi i Shafiut.

Pasuesit e mendimit të parë argumentuan me këto argumente.

Transmetimin e Tirmidhiut, Hakimit, Ibën Adiut, Dereikutnit e tjerë, nga rruga e Ismail ibën Muslin El-Mekkit, nga Haseni nga Xhundubi se ka thënë: Thotë Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem: “Dënimi i magjistarit është të i pritët koka”.

Tirmidhiu thotë: Këtë hadith nuk e dimë merfu vetëm nga kjo rrugë e hadithit, ndërsa Ismail bin Muslin El-Mekki dobësohet në hadith, më e vërtetë është se kjo është prej fjalës së Xhundubit.

Për Ismail bin Muslin thotë Imam Ahmedit. Këtij i refuzohet hadithi. Imam Maini thotë: “Nuk është send”, ndërsa Dhehebiu thotë: “Janë pajtuar se është i dobët”.

Gjithashtu kanë argumentuar me atë që ka transmetuar Ahmedit etj. me zinxhir transmetuesish të vërtetë dhe autentik nga Bexhale se ka thënë. Na erdhi letra e Omerit, radijallahu anhu, një vit para se të ndërronte jetë që të mbytni çdo magjistarë, ndani çdo martesë të ndaluar të zjarrputistëve (adhuruesit e zjarrit dhe ndaloni nga Zemzemetu (fjali që pëshpëritnin gjatë hajes zjarrputistët).

Argumentojnë po ashtu me etherin e Hafsas, radijallahu anhu, që urdhëroi të mbytet një robëreshë e saj e cila i kishte bërë magji. Këtë ether e transmeton Maliku në “Muvata”, ndërsa zinxhiri është i këputur.

Transmeton Abdullahu, djali i Imam Ahmedit në “Mesail”, Bejakiu me zinxhir të vërtetë, këtë ether e ka bërë të vërtetë Shejhul Islam Muhamed ibën Abdulvehabi në librin e tij “Kitab-Teuhid”.

Ky mendim për mbytjen e magjistarit në përgjithësi është mendimi më i vërtetë, sepse nuk dihet se dikush e ka kundërshtuar Omerin, Hafsën dhe Xhundubin në këtë çështje.

Transmetohet nga Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, se ka thënë: “Merrni shembëlltyrë dy pas meje, Ebu Bekrin dhe Omerin”. Dhe gjithashtu ka thënë: “Allahu, subhanehu ve teala, e ka bërë të vërtetën në gjuhën dhe zemrën e Omerit”. [Ky hadith është i vërtetë]

Sa i përket mendimit të atyre që thonë se magjistari nuk mbytet nëse nuk arrin me magjinë e vet në kufër, kanë argumentuar me fjalën e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem: “Nuk lejohet gjaku i muslimanit vetëm se me njërën prej tri rasteve: zinaqari i martuar, shpirti për shpirt, lënësi i fesë”. Por në të argumentuarit me këtë ka dyshim në shumë aspekte. Ndërsa sa i përket mosmbytjes së Lebid ibën El-Easam nga ana e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, është për shkak të mospërhapjes së fitnes, ndërsa Allahu e din më së miri!

Disa dijetarë thonë: Kjo është e veçantë për ata që paguajnë tatim nga kafirat që t'i mbrojnë muslimanët, por më e vërteta është se ky edhe muslimani janë të barabartë në mbytjen e tyre.

Shërimi nga të bërit sihër

Ajo është fryerja që i bëhet të sëmurit që të shërohet.

Thotë **Ibën Kajimi**, rahimehullah. Shërimi i sihrit nga i sëmuri me sihër bëhet në dy mënyra:

1. Shërimi me anë të sihrit njësoj, kjo është prej veprave të shejtanëve, në këtë mënyrë bartet fjala e thënë nga Hasan el-Basriu. Nuk mund ta zgjidh sihrin vetëm se sehiri (magjistari). Në këtë mënyrë afrohet ai që bën hajmalinë tek shejtani me atë që don shejtani, dhe me këtë prish veprën e bërë ndaj të bërit sihër (të sëmurit prej sihrit). Kjo mënyrë është e ndaluar.

2. Të shëruarit me anë të fryerjes, me rukje, kërkon mbrojtje me lutje dhe ilaçe që lejohen në Islam. Kjo mënyrë është e lejuar.

Sa i përket asaj që transmeton Buhariu pa zinxhir nga Katadeja që thotë: I thashë Ibën Musejebit: Një njeriut i është bërë sihër, pengohet prej gruas së tij, a lejohet që të zgjidhë atë me hajmali. Tha: Nuk shoh të keqe, duan që të përmirësojnë me këtë, ajo që bën dobi, nuk është ndaluar.

Kjo bartet në atë lloj të lejuar të hajmalive, sepse hadithi është i vërtetë nga Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, kur u pyet për hajmalitë, tha: **“Ato janë prej veprave të shejtanit”**.

Sa i përket të shkuarit te magjistarët, bestytënjakët dhe fallxhorët që t'i pyet ata, kjo është krim i madh dhe rrezik i madh. Me këtë nuk i pranohet namazi katërdhjetë netë, sepse [Transmeton Muslimi në **“Sahihun” e tij (2230)**], prej hadithit të Jahja ibën Seid nga Ubejdullahu nga Nafiu nga Safija nga disa prej grave të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, nga i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, se ka thënë: “Kush shkon te fallxhori që ta pyet për diçka nuk i pranohet namazi katërdhjetë netë”.

Por nëse i pyet ata dhe iu beson atyre bëhet kafir ndaj asaj që i ka zbritur Muhamedit, salallahu alejhi ve selem. Transmeton Hakimi me zinxhir të

vërtetë nga rruga e Aufit nga Halasi dhe Muhamedi nga Ebu Hurejra se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Kush shkon tek fallxhori dhe i beson asaj që flet me të vërtetë e ka mohuar atë që i ka zbrit Muhamedit, salallahu alejhi ve selem”.

Kush shkon te fallxhori apo magjistari dhe i beson asaj që flet, me të vërtetë e ka mohuar atë që i është zbritur Muhamedit, salallahu alejhi ve selem.

Negacioni i tetë

Autori thotë: **“Të ndihmuarit e mushrikëve, dhe të ndihmuarit e tyre kundër muslimanëve, argument për këtë është fjala e Allahut: “O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtetë Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqarë”. [El-Maide: 51]**

Të ndihmuarit e mushrikëve idhujtarëve kundër muslimanëve është fitne e madhe që është shpërndarë në këto kohëra, sprovë që i ka bërë njerëzit të shurdhër, fitne që i fton të gjithë zemrat, por i përgjigjet çdo zemër e dhënë pas dashurisë ndaj idhujtarëve, e posaçërisht në këtë kohë në të cilën është shtuar padituria, është pakësuar dituria mbi këtë, shkaqet e sprovës janë të mundshme, ka fituar epshi dhe gjykohet në te, janë zhdukur shenjat e Sunetit të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem.

Tek unë e gjithë kjo është për shkak të largimit të njerëzve nga mësimi i diturive filozofike-greke.

Nuk ka lëvizje e as forcë pos me ndihmën e Allahut.

Është bërë e mira e keqe, e keqja e mirë, u rrit me këtë i vogli, e u mplak me këtë i madhi. Pronari i së vërtetës është i huaj në mesin e njerëzve, i huaj në mesin e familjes etj. Nëse kërkon ndihmës, nuk e gjen dot, e nëse kërkon shok të kapur për Sunetin e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, nuk e gjen vetëm se me vështirësi e mund.

U bë Islami i huaj tek njerëzit, u kthye i huaj ashtu siç ishte në fillim. Përgëzim

për këta të huaj që përmirësojnë atë që njerëzit e prishin.

Zgjedhja dhe rrugëdalja nga kjo sprovë është të ndalurit e të ndihmuarit të idhujtarëve (mushrikëve) kundër muslimanëve, sepse të ndihmuarit e tyre është dalje nga Islami.

Është pyetur dijetari Abdullah ibën Abdu Latifi, po të ishin bërë muslimanët një grusht bashkë ndaj atyre tiranëve kriminel, po të ishin ndihmuar mes veti, do të kishte Islami dhe muslimanët një rol tjetër nga të cilin e kemi neve tani. Do të ishin bërë kafirat të mposhtur, do të kishin paguar tatim, ashtu siç i kanë paguar Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, dhe shokëve të tij në dorë dhe të mposhtur.

Pastaj dije se të ndihmuarit e kafirave bëhet me çdo send që forcohen me të dhe ndihmohen kundër muslimanëve në numër dhe përgatitje.

Negacioni i nëntë

Autori, Allahu e mëshiroftë, thotë: **“Kush beson se disa njerëzve iu lejohet dalja nga Sherijati i Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, pikërisht ashtu siç është lejuar dalja e Hidrit prej sherijati të Musës, alejhi selam, ky është kafir”.**

Kjo është kështu, ngase e refuzon fjalën e Allaht, subhanehu ve teala:

“Dhe kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni.” [El-En’am: 153]

Ibën Mesudi, radijallahu anhu ka thënë: Na e vizatoi Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, një vije e pastaj tha: **“Kjo është rruga e Allahut”.** Pastaj bëri disa vijëza në të djathtë dhe të majtë, pastaj tha: **“Këto janë rrugët e devijuara, në çdo rrugë prej tyre ka shejtan që thërret në të”, pastaj lexoi** [Transmeton Ahmed, Ebu Davudi, Tajalesiu, Daremiu]

Allahu te’ala thotë: **“Dhe kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e**

Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni [El-En'am: 153]

Kush don që të largohet nga Sherijati i Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, apo mendon se nuk ka nevojë për të, me të vërtetë e ka larguar litarin e Islamit nga qafa (supet) e tij.

Imam Ibën Abdulvehabi, rahimehullah, ka shkruar kaptinë të gjërë mbi “Vlerën e Islamit”, e atë e ka titulluar si “Kaptina e të mjaftuarit me pasimin e Kur’anit, nga çdo send tjetër përveç tij”.

Nuk ka dyshim se Kur’ani na urdhëron ta pasojmë Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem, dhe mos të dalim nga respekti i tij, bile të ndalurit nga respekti i tij është prej shkaqeve që të dërgojnë në zjarr. Nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, i cili thotë: Tha Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem: **“I gjithë umeti im do të hyjë në Xhenet, përveç atyre që nuk duan”**. Thanë: O i dërguari i Allahut kush nuk don të hyjë? Tha: **Kush më respekton mua do të hyjë në Xhenet e kush më kundërshton vetëm se ka refuzuar**”. [Siç transmetohet në {“Musned” të Ahmedit, dhe “Sahih el-Buhari”}]

Pastaj vendosi shejhu Fjalën e Allahut:

“Dhe (përkujtoju njerëzve) atë ditë, kur në secilin popull do të sjellim dëshmitarë kundër tyre, e ty të sjellim dëshmitarë kundër atyre. Ne ty të shpallëm librin sqarim për çdo send, udhëzim dhe mëshirë dhe muzhde për muslimanët.” [Nahël: 89]

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka parë një letër nga Teurati në dorën e Omerit, radijallahu anhu, e i ka thënë: **“A i hutuar je o biri i Hatabit? Me të vërtetë ju kam ardhur me këtë Kur’an të bardhë, i pastër, po të ishte Musai gjallë dhe do ta pasonit atë do të kishit devijuar”**. Në një transmetim: **“Po të ishte Musai gjallë, do ta kishte pasuar, patjetër të më pasoje mua”**. Tha Omeri, radijallahu anhu: **“Jam i kënaqur me Allahun për Zot, me Islamin për fe, dhe Muhamedin, salallahu alejhi ve selem, për të dërguar”**. [Transmeton: Nesaiu edhe të tjerët]

Ky hadith na tregon tekstualisht se nuk i lejohet asnjërit të del jashtë Sherijatit të Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, dhe argumentet për këtë janë të shumta.

Shokët e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, ishin njerëz më të dijshtëm mbi Allahun, subhanehu ve teala, me iman më të fortë. Ata nuk dinin diç tjetër jashtë pasimit, madhërimit, respektimit të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, nuk dinin diç tjetër pos pasimit të dritës së zbritur atij, sepse Allahu, subhanehu ve teala, i kishte zgjedhur ata që ta shoqërojnë Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem.

Transmeton Ahmedi, Bezzari dhe të tjerë me zinxhir të mirë nga Ibën Mesudi, radijallahu anhu, i cili thotë: “Me të vërtetë Allahu, subhanehu ve teala, ka shikuar në zemrat e robërve të Tij, dhe gjeti zemrën e Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, zemrën më të mirë, pastaj shikoi në zemrat e robërve dhe gjeti zemrat e shokëve të tij, zemrat më të mira prej robërve të Tij. I bëri ministra të Pejgamberit të Tij, luftojnë për fenë e Tij, atë që muslimanët e shohin të mire, edhe tek Allahu është e mirë, e atë që e shohin të keqe edhe tek Allahu është e keqe.

Allahu, subhanehu ve teala, ua ka bërë obligim të gjithë njerëzve respektimin e Tij, pastaj ka prej tyre që respektojnë e prej tyre që kundërshtojnë.

Umeti është ndarë në dy grupe.

1.Umeti që u përgjigj, ata janë që respektuan dhe pasuan dritën që është me Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem.

Umeti i thirrjes, janë ata që u bënë mendjemëdhenj ndaj respektit. Shejhu Islam Ibën Tejmie, rahimehullah, thotë: “Ka prej tyre që mendojnë se të larguarit nga Sherijati, duke i respektuar urdhërat dhe ndalesat, është obligim për të derisa mos të arrij në ndonjë njohuri dhe gjendje (të misticizmit).

Ndërsa nëse arrin, atëherë nuk i është obliguar të kapet për Sherijatit e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, atëherë i takon atij që të ecë pas realitetit të kësaj bote që i është caktuar. Apo të veprojë sipas dëshirave, shijes,

dhe mendimit të tij duke mos u kapur për Kur'an dhe Sunet. Ka prej tyre që dënohet duke ia larguar gjendjen që e ka (në misticizëm) derisa të bëhet i privuar e i dobët, e prej tyre ka që dënohen me largim nga punët e mira derisa të bëhet fasikë, ndërsa ka edhe prej atyre që dënohen me largimin e imanit nga ai derisa të bëhet murted – munafik, apo kafir i hapët.

Këso lloj njerëzish janë të shumtë, dhe shumica prej tyre argumentojnë me ngjarjen e Musait, alejhi selam, dhe Hidrit. ThotëAllahu e mëshiroftë një faqe pas këtyre fjalëve. Sa i përket të argumentuarit me ngjarjen e Musait me Hidrin, argumentohet në dy aspekte.

1. Të thonë se Hidri e shihte vullnetin e Allahut që kaplon dhe dëshirën e Allahut në përgjithësi, e mu për këtë nuk u qortua për kundërshtimin e urdhërit dhe ndalesës së Sherijatit. Kjo është prej mosditurisë dhe devijimit të madh bile prej nifakut dhe kufrit të madh.

Nga kjo fjalë nënkuptojmë se ai që e beson kaderin, dhe dëshmon se Allahu është Zot i çdo sendi se për këtë nuk ka urdhër as ndalesë.

2. Ka prej tyre që mendojnë se disa prej evliave iu lejohet të dalin nga Sherijati i Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, mu ashtu si iu lejua Hidrit të dalë jashtë pasimit të Musait, alejhi selam, dhe se evliatë nuk ka nevojë që ta pasojnë të dërguarin. Ka shumë prej tyre e vlerëson më shumë se Pejgamberi në përgjithësi apo në disa aspekte, duke pretenduar se në ngjarjen e Hidrit kanë argument.

Të gjitha këto fjalë janë prej injorancës dhe devijimit më të madh, bile kjo është prej nifakut, shtrembërimit dhe kufrit më të madh.

Është e njohur prej fesë islame se mesazhi i Muhamed ibën Abdullahut është për të gjithë njerëzit në përgjithësi, për arabët dhe joarabët, për mbretërit dhe asketët, për dijetarët dhe analfabetët. Dhe kjo do të vazhdojë përgjithmonë deri në Ditën e Gjykimit për gjithë njerëzit dhe xhinët.

Nuk i takon asnjërit prej krijesave të dalë jashtë respektit dhe pasimit të tij, duhet të kapen për atë që ua bën të ligjshme për umetin e tij në fe dhe të pasojnë atë që i urdhëron dhe ndalon prej veprave. Po të ishin pejgamberët e

mëposhtëm gjallë do të ishte e obliguar që ta pasojmë atë. Derisa tha, Allahu e mëshiroftë: Bile ka ardhur në hadithe të vërteta se Mesihu, Isai, i biri i Merjemes kur do të zbret prej qielli do të jetë pasues i Sherijatit të Muhamed ibën Abdullahut. Ky është obligim për pejgamberët që do ta takojnë të respektuarit dhe ndihmuarit e si është halli i atyre që janë më poshtë se ata. Është e njohur në fenë islame se nuk i lejohet atij që i arrin thirrja e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, që të pasojë Sherijat të pejgamberit tjetër siç janë Musai dhe Isai. Pra, nuk është e lejuar të dalurit nga Sherijati i Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, në sherijat të pejgamberëve tjerë, si mund të lejohet të dalurit nga Sherijati i tij dhe pejgamberëve tjerë. Thotë më poshtë: “Prej pikave që tregon gabimin në të cilin kanë rënë me të argumentuarit me ngjarjen e Musait dhe Hidrit në kundërshtimin e Sherijatit është se Musai, alejhi selam, nuk ishte i dërguar tek Hidri, e as që Allahu, subhanehu ve teala, ia bëri obligim Hidrit pasimin dhe respektin e tij. Transmetohet në dy sahihet se Hidri i ka thënë Musait: “O Musa, unë e kam një dituri që ma ka mësuar Allahu, të cilën ti nuk e din, ndërsa ti ke një dituri prej diturisë të Allahut që ta ka mësuar ty, të cilën unë nuk e di”. Kjo ngase thirrja e Musait, alejhi selam, ishte e veçantë. Transmetohet në sahihe, në më shumë rrugë nga Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, se ai ka thënë për vlerësimin që ia ka dhënë Allahu, subhanehu ve teala, krahas Pejgamberëve tjerë, u dërgonte Pejgamberi tek populli i vet vetëm, ndërsa unë u dërgova tek njerëzit në përgjithësi”. Thirrja e Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, është e përgjithshme për të gjithë robërit, nuk i takon asnjërit të dal nga pasimi dhe respekti i tij ashtu siç iu lejua Hidrit të del nga pasimi dhe respekti i Musait. Nuk pati nevojë, ngase Allahu e pat mësuar atë. Nuk i lejohet asnjërit që e takon Islamit t’i thotë Muhamedit, salallahu alejhi ve selem: Unë kam një dituri që ma ka mësuar Allahu prej diturisë së Allahut që ti nuk e din. Ai që këtë e lejon, apo beson se ndonjërit prej zahidëve, ibadetçinjëve apo

tjerëve iu lejohej të dalë jashtë respektit të thirrjes së Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, dhe pasimit të tij, ky njeri është kafir me pajtimin e të gjithë muslimanëve. Argumentet për këtë janë të shumta në Kur'an dhe Sunet. Në ngjarjen e Hidrit nuk ka argument për daljen nga Sherijati, mu për këtë atëherë kur ia sqaroi Hidri shkaqet për se i bëri ato vepra u pajtua me të Musa dhe nuk u përçanë, po të ishte ajo që bëri Hidri në kundërshtim me Sherijatën e Musait, alejhi selam, nuk do të pajtohej me të". Mbaruan fjalët e Ibën Tejmijes, në to ka sqarim që shënon.

Me këtë na bëhet e qartë se nuk i lejohej asnjërit të pretendon dalje nga Sherijati i Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, ashtu siç pretendojnë ata që e teprojnë në misticizëm (sufizëm) duke komentuar fjalën e Allahut:

"Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë ty e vërteta (vdekja)". [Hixhër: 99]

Do të thotë dituri dhe njohuri, i lejojnë atij që arrin dituri dhe njohuri të dalë nga Sherijati i Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, dhe pretendojnë se ky njeri nuk ka obligime. Kjo është dalje nga Islami me pajtimin e të gjithë dijetarëve.

Sa mirë thotë Ibën Kajimi në "Nunijen" e tij: "Kufri nuk është diç tjetër vetëm se inat dhe refuzim i fjalës së Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, për shkak të fjalës së filanit".

Nëse është kufër refuzimi asaj me të cilën ka ardhur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, si është puna e daljes nga Sherijati i tij në përgjithësi?!

Negacioni i dhjetë dhe i fundit

Autori, Allahu e mëshiroftë, thotë: **"Të larguarit nga feja e Allahut, nuk e mëson atë e as nuk vepron me të".**

Argument për këtë është fjala e Allahut: **"E kush është më zullumqarë se ai që**

këshillohet me ajetet e Zotit të vet, e pastaj u kthyen shpinën atyre? Ne me siguri do të hakmerremi kundër kriminelëve". [Sexhde: 22]

Për largim e kemi qëllimin largimin nga mësimi i bazave të fesë me të cilën njeriu bëhet musliman. Nuk e kemi për qëllim mësimin e fesë në detaje, sepse këtë nuk mund ta bëjnë vetëm se dijetarët dhe kërkuesit e diturisë.

Është pyetur dijetari Abdulatif ibën Abdurahman bin Hasen për largimin nga feja (dalja nga feja), është përgjigjur duke thënë: "Gjendjet e njerëzve dallojnë me një dallim të madh. Dallimi i tyre është sipas dallimit në iman, nëse baza e imanit gjendet tek ata. Mangësitë dhe shirku janë pas kësaj prej obligimeve dhe mustehabateve, ndërsa kur të humbet baza e imanit me të cilën hyn njeriu në Islam dhe largohet nga kjo krejtësisht, kjo pra është kufër i largimit nga feja e Allahut, për këtë është fjala e Allahut: **"Ne krijuam shumë nga xhinët dhe njerëzit për xhehenem. Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillë janë ata të marrët"**. [Araf: 179] Dhe thotë: **"E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kijametit do ta ringjallim të verbër."** [Taha: 124]

Dijetari Sulejman ibën Suhmani thotë: "Prej fjalëve të shejhut na u bë e qartë se njeriu nuk bën kufër vetëm atëherë kur të largohet nga mësimi i bazës me të cilën njeriu hyn në Islam, e jo në lënien e obligimeve dhe gjërave të pëlqyera".

Ibën Kajimi në "Medarixhu salikin" thotë: "Sa i përket kufrit të madh ai është pesë llojësh, dhe mëpastaj i përmend...". Pastaj shton: "Sa i përket kufrit të largimit nga feja, ai me dëgjimin dhe zemrën largohet nga Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, nuk e vërteton e as nuk e përgënjeshtrohet, as nuk e miqëson po as nuk e armiqëson, as nuk i vënë veshin ndonjëherë.

Nga ky sqarim mbi kuptimin e largimit nga feja të bëhet e qartë dispozita mbi disa që i adhurojnë varret në kohën tonë dhe më herët. Ata janë larguar nga kjo me të cilën Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka ardhur, me një largim

të plotë, me zemër dhe dëgjim. Nuk ia vënë veshin këshillës së këshilluesit e as udhëzimit të udhëzuesit. Çifti i këtyre janë kafira për shkak të largimit të tyre nga feja.

Thotë Allahu, subhanehu ve teala: **“Ne nuk i krijuam qiejt e tokën dhe atë që ekziston ndërmjet tyre, përpos me qëllim dhe për një afat të caktuar, kurse ata që nuk besuan nuk i vunë veshin asaj me çka u tërhiqet vërejtja”**. [Ahkaf: 3]

Për këta njerëz nuk thuhet se janë të paditur dhe se nuk bëhen kafira për shkak të injorancës së tyre, ngase injorantit atëherë kur t’i sqarohet gabimi i nënshtrohet të vërtetës dhe kthehet nga e kota. Ndërsa këta janë që vazhdojnë në adhurim ndaj idhujve dhe nuk i vënë veshin fjalës së Allahut dhe të Dërguarit të Tij, salallahu alejhi ve selem, dhe pengojnë njerëzit nga udhëzimi i këshillëdhënësve. Këta janë që e mundojnë atë i ndalon nga e kota dhe imoraliteti i tyre. Argumentet iu janë bërë të qarta atyre, ata nuk kanë arsye, vetëm vazhdojnë në inatin e tyre.

Thotë Allahu, subhanehu ve teala: **“E kush është më zullumqarë se ai që këshillohet me ajetet e Zotit të vet, e pastaj u kthyen shpinën atyre? Ne me siguri do të hakmerremi kundër kriminelëve”**. [Sexhde: 22]

Dispozita e tallësit, seriozit, të frikësuarit dhe dhunuarit (në veprimin e këtyre negacioneve)

Pasi që autori, rahimehullah, i përmendi të gjitha këto dhjetë negacione, thotë: **“Nuk ka dallim në këto negacione mes tallësit, seriozit dhe të frikësuarit përveç të dhunuarit (mubreh).**

Argument për arsyetimin e dhunës është fjala e Allahut, subhanehu ve teala: **“Ai që pas besimit të tij e mohon Allahun, me përjashtim të atij që dhunohet (për të mohuar), e zemra e tij është e bindur plotësisht me besim, por fjala është për atë që ia hap gjoksin mosbesimit, ata i ka kapur hidhërimi nga Allahu dhe ata kanë një dënim të madh”**. [Nahël: 106]

Dhuna mund të jetë me fjalë dhe në vepra. Ndërsa fjala e atyre që thonë se në

vepra nuk ka dhunë nuk është në pajtim me kuptimin e jashtëm të nijetit. Që të gjitha këto negacione janë rreziqe të mëdha, dhe ndodhin shpesh tek njerëzit.

- **Kaptina e dytë:** Besimi (Imani) me kushtet e saja, dhe çfarë e mohon atë (Kufri).

Kushtet e Besimit janë:

- Transmetohet nga Umer ibn Hattabi r.a se ka thënë: “Një ditë ishim duke ndenjur tek i Dërguari i Allahu [salallahu alejhi ve selem] kur u duk një njeri me rroba shumë të bardha dhe flokë shumë të zeza. Në të nuk hetohesh shenja e udhëtimit dhe askush prej nesh nuk e njohëm. U ul pranë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] duke i mbështetur gjunjët e vet në gjunjët e tij, i vendosi duart e veta në kofshën e tij dhe tha: “O Muhammed, më trego ç’është Islami?” I Dërguari i Allahut [salallahu alejhi ve selem] tha: “Islami është të dëshmosh se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Allahut, ta kryesh namazin, ta ndash zekatin, ta agjërosh Ramazanin, ta vizitosh Qa’benë, nëse ke mundësi ta bësh këtë!” Ai tha: “Të vërtetën e the”. Ne u çuditëm. Po e pyet dhe po ia vërteton. Ai tha: “Më trego ç’është Imani? (Pejgamberi) Tha: “Të besosh Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e fundit dhe të besosh në të caktuarit e Tij të të mirës dhe të keqes”. Tha: “Të vërtetën e the”. Tha: “Më trego ç’është ihsani?” (Pejgamberi) Tha: “Ta adhurosh Allahun sikur ta shohësh, sepse edhe pse ti nuk e sheh, Ai vërtet të sheh ty”. Tha: “Më trego ç’është çasti (i fundit, Dita e shkatërimit)?” (Pejgamberi) Tha: “Për këtë i pyeturi nuk di më shumë nga ai që pyet”. Tha: “Më trego mbi shenjat e tij?” (Pejgamberi) Tha: “Kur robëresha t’i i lindë vetes zonjushë, kur të shihen barinj të këmbëzbathur, të zheshur e të mjerë se si garojnë në ndërtimin e gadinave të mëdha”. Pastaj shkoi, kurse unë mbeta një kohë. Pastaj (i Dërguari) tha: “O Umer, a e di kush ishte pyetësi?” Thashë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij më së miri e dinë”. Tha: “Vërtet ishte Xhibrili, erdhi t’ua mësojë fenë tuaj”.

Besimi në Allahun, besimi në Melekët e Tij, besimi në Librat e Tij, besimi në të Dërguarit e Tij, besimi në Ditën e Fundit dhe besimi në Kaderin e Tij qoftë i mirë apo jo i mirë.

Allahu i Lartësuar thotë: "... por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson **Allahut, Ditës së Fundit, melekëve, librit, të Dërguarve ...**" [El-Bekare: 177]

Gjithashtu thotë: "... Secili i besoi All-llahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të Dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të Dërguarit e Tij ..." [El-Bekare: 258]

Gjithashtu thotë: "Ne çdo send e kemi krijuar me kader (caktim)". [El-Kamer: 49]

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. **"Imani është të besosh Allahun, Melekët e Tij, librat e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh në Caktimin (Kaderin) qoftë i mirë apo jo i mirë"**. [Transmeton: Muslimi]

Imani është fjalë me gjuhë, bindje me zemër dhe veprim me gjymtyrë, shtohet me punë të mira dhe pakësohet me mëkate.

Allahu i Lartësuar thotë: **"E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur përmendet Allahu u rrëngqethen zemrat e tyre, kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre. Dhe, të cilët falin namazin dhe nga ajo, me çka Ne i furnizuar, ata japin. Të tillët janë besimtarë të vërtetë dhe për këtë kanë vende të larta te Zoti i tyre, kanë falje dhe kanë furnizim në mënyrë të ndershme"**. [El-Enfal: 2, 4]

Gjithashtu thotë: "... Kush nuk i beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe ditës së fundit, ai ka humbur tepër larg". [En-Nisa': 136]

Imani mundet me qenë me gjuhë, p.sh. Përkujtimi i Zotit (dhikri), lutja (duaaja), urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, leximi i Kur'anit e të ngjashme. Mundet me qenë edhe me zemër, p.sh.

Bindja në Njësinë e Allahut në Zotërim, në Adhurim, në Emrat e Cilësitë e Tij dhe në obligimin e adhurimit të Allahut Një e të pa shoq dhe gjithë çka hyn në të qoftë nijet apo qëllim. Në përkufizimin e besimit hyjnë edhe punët e zemrës, siç janë: Të dashurit e Allahut, frika e shpresa ndaj Zotit, mbështetja në Të (tevekkuli) e të ngjashme. E hyjnë në këtë përkufizim edhe veprat e gjymtyrëve, siç janë: Namazi, agjërimi dhe kushtet tjera të Islamit, Lufta në Rrugën e Allahut, kërkimi i dijes e të ngjashme. Allahu i Lartësuar thotë:

"...kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi..." [El-Enfal: 2]

Gjithashtu thotë: **"Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë për ta shtuar ata bindjen në besimin e vet që kishin"**. [El-Fet'h: 4]

Imani shtohet sa herë që shtohen veprat e mira të robit dhe ato me të cilat i afrohet Zotit dhe pakësohet sa herë që pakësohen veprat e mira të tij dhe ato me të cilat i afrohet Zotit.

Gjithashtu ndikojnë edhe mëkatet.

Nëse mëkati është shirk i madh, apo kufër i madh, atëherë zhvlerësohet esenca e besimit të ligjshëm dhe e ka prishur besimin dhe gjitha mëkatet tjera që i bën robi në përjashtim të shirkut dhe kufrit, atëherë imani i tij dobësohet. Allahu i Lartësuar thotë: **"S'ka dyshim se Allahu nuk falë (mëkatin) t'i përshkruhet Atij shok (shirkun e madh), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do ..."** [En-Nisa': 48]

Shumë mirë e dimë se të gjithë dijetarët të Ehli-Sunnetit janë të pajtimit se **imani është fjalë dhe vepër.**

Kemi thënien e **Imam Shafiut** (rahimehullah) ku ka thënë: "Ka pajtueshmëri të Sahabët (Shokët e Pejgamberit sal-laAllahu alejhi ue sel-lem), dhe të Tabiinët (gjeneratat e parë të arta), të kenë thënë se Imani është fjalë, vepër dhe nijet dhe nuk zëvendësohet njëra prej të triave përveç mes veti.

[Shpjegimi i besimit të Ehli-Suneti dhe Xhemati. 5/, 956-957]

Dhe thënia e **Imam Euzait** (rahimehullah), : "Nuk qëndron Imani vetëm me fjalë e pa vepër, dhe nuk qëndron imani me fjalë me vepër e pa pajtimin e sunnetit, sepse kanë qenë të parët tanë, dhe se ato nuk e kanë dalluar imanin prej veprës dhe veprën prej imanin, mirëpo imani është një emër që i përmbledh të gjitha duke i vërtetuar ato me vepra, dhe kush beson me fjalë dhe ka njohur me zemër dhe e vërteton me vepër, le ta dinë se ky është kapur për një litar të fortë që nuk ka këputje, dhe kush beson me fjalë dhe nuk e njeh me zemër dhe nuk vepron me vepër, atij personi nuk i pranohet kjo në asnjë mënyrë dhe se ai është prej të humburve. [El-Iman të Ibn Batës/2/807]

Ka thënë **Sufjan ibn Ujejne** (rahimehullah) : "**Kemi marrë prej atyre që ishin para nesh se imani është fjalë dhe vepër dhe nuk ka mundësi të jetë fjala pa vepër.** [El-Suneh Li-Abdullah ibn Ahmed /346]

Dhe ka përmendur **Ibn Rexhebi** (rahimehullah) prej emrave që kanë kaluar dhe që kanë treguar se ka koncenzues prej selefëve (Sahabet, tabiinët) dhe ka përmendur prej tyre Imam Shafiun, Eba Theur, Fudejl ibn Ijad, Veki' ibn Xherah, gjithashtu është transmetuar se ka koncenzues nga Ibn Abdul-Bir dhe Imam Begavij, Imam Taberiu, Ibn Ebu Asim, dhe Ebu Ubejd el-Kasim bin Selam dhe nga shumë dijetarë të tjerë.

[Shiko Fet'hul-Bari 1/5 dhe në vëllimin e Ibn Abdul-Berit 9/238, dhe te libri el-Iman të Ibn Tejmijës/241]

Dhe kemi prej dijetarëve që kanë theksuar këtë rregull shumë qartë. Vetëm se e ka theksuar **Imam Taberiu** (rahimehullah) në qartësimin e sunnehit me sened nga El-Velid bin Muslim se ka thënë : "**Nuk ka iman pa vepër dhe nuk ka vepër pa iman.**" [Qartësimi i Sunnehit të Taberit/25]

Gjithashtu edhe **Imam el-Mazeni** ka qartësuar dhe ka thënë: "Imani është fjalë dhe vepër me vërtetësinë e gjymtyrëve të jashtme, duke deklaruar me fjalë dhe duke vepruar me vepra dhe dy shtyllat janë të barabartë dhe janë të njëjtë

që nuk kanë dallim mes veti, nuk ka iman pa vepër dhe nuk ka vepër pa iman". [Shpjegim El-Sunneh/ El-Mazenij/ 71]

Ndërsa prej veprave të zemrës janë: nënshtrimi, pranimi, besimi, mbështetja, bindja, frika, sinqeriteti, dashuria etj.

Argumente nga Kur'ani.

Allahu Te'ala thotë: "Dhe mos i përzë ata që adhurojnë Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, duke qenë të sinqertë ndaj Tij. Ti nuk përgjigjesh asgjë nga llogaria e tyre e as ata nuk kanë kurrfarë përgjegjësie nga llogaria jote, e po i dëbove ata do të bëhesh nga të padrejtët". [El-En'am, 52]

Allahu Te'ala thotë: 'E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre, kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre". [El-Enfal, 2]

Allahu Te'ala thotë: 'dhe, ata të cilët japin [sadaka-zeqatë] nga ajo që u është dhënë, pse dinë se do të kthehen te Zoti i tyre, andaj zemrat e tyre i kanë të frikësuar'. [El-Mu'minun, 60]

Allahu Te'ala thotë: "E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejt". [El-Bejjineh, 5]

Gjithashtu Allahu Te'ala thotë: "por All-llahu juve ua bëri të dashur besimin dhe ua zbukuroi atë në zemrat tuaja, ndërsa mosbesimin, shfrenimin dhe kundërshtimin, ua bëri që t'i urreni. Të tillë janë ata që gjetën rrugën e drejtë". [El-Huxhurat]

Transmeton Buhariu nga Ebu Hurejra r.a. se i dërguari, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: **“Kush ngritët në ramazan me iman dhe durim, duke shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e kaluara”**. [Transmeton: Buhariu nr, 37]

Transmeton Ibn Ebi Shejbe se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë **"Nyja më e forte është dashuria për hire të Allahut dhe urrejtja për hire të Allahut"**. [Shejh Albani thotë: hadithi është i mire. Shih: Silsiletu el-Sahih nr, 1728]

Transmeton Buhariu nga Enesi r.a se i Dërguari i Allahut ka thënë **"Shenjë e imanit është dashuria ndaj ensarëve dhe shenjë e hipokrizisë është urrejtja ndaj ensarëve"**. [Buhariu nr.17 dhe Muslimi nr.235]

Transmeton Buhariu nga Enes ibn Maliku se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: **"Nuk beson dikush nga ju derisa nuk e do për vëllaun e tij atë që e dëshiron për vete."** [Buhariu nr.13 dhe Muslimi nr.170]

Veprat e gjymtyrëve

Vepra të gjymtyrëve janë: të gjitha ato vepra të cilat i kryejmë me gjymtyrë e që Allahu është i kënaqur me to.

Argumente nga Kur'ani

Allahu Te'ala thotë: **"Falni namazin dhe jepni zeqatin, dhe përuluni [në ruku] me ata që përulen."** [El-Bekare, 43]

Allahu Te'ala thotë: **"Dhe luftoni në rrugën e All-llahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se All-llahu nuk i do ata që e teprojnë [e fillojnë luftën]."** [El-Bekare, 190]

Alghimërit nga Steneti. "Ata që besuan luftojnë në rrugë të All-llahut, e ata që nuk besuan luftojnë në rrugë të djallëzuar. Luftoni pra miqtë e djallit, s'ka dyshim se intriga e djallit është e dobët." [En-Nisa, 76]

Allahu Te'ala thotë: "O ju që besuat, falni namazin me ruku e sexhde dhe vetëm Zotin tuaj adhuron. Bëni punë të mira [të dobishme], se do të gjeni shpëtim." [El-Haxh, 77]

Allahu Te'ala thotë: "E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: "Paqe!" Dhe që për hir të Zotit të tyre natën e kalojnë duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë [fale]. Edhe ata që thonë: "Zoti ynë, largoje prej nesh vuajtjen e Xhehennemit, e s'ka dyshim se vuajtja në të është gjëja më e rëndë. Ai, vërtet është vendqëndrim i keq. Edhe ata që kur shpenzojnë nuk e teprojnë e as nuk janë dorështrenguar, po mbajnë mesataren e janë të matur. Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin. Atij i dyfishohet dënimi ditën e kijametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë. Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve All-llahu të këqijat ua shndërron në të mira. All-llahu është mëshirues, ndaj Ai falë shumë. Ai që është penduar dhe ka bërë mirë, në të vërtetë, ai është kthyer tek All-llahu dhe është i pranishëm. (Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur [rastësisht] kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet. Edhe ata që kur këshillohen me ajetet e Kur'anit të Zotit të tyre, nuk u kthejnë shpinën si të shurdhët e të verbër. Edhe ata që thonë: "Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me [punën] e grave tona dhe pasardhësve tanë, neve na bën shembull për të devotshmit". Për shkak se duruan, të tillët shpërblehen me një shkallë të lartë [Xhennet] dhe aty priten me përshëndetje të selamit. Aty janë përgjithmonë, e sa vendqëndrim dhe vendbanim i mirë është ai. Thuaj: "Zoti im as nuk do të

kujdesej për ju, sikur të mos ishte lutja juaj [kur gjendeni në vështirësi, ose sikur të mos ishit të thirrur të besoni], e ju përgënjeshtrohet, andaj dënimi do t'ju jetë i pandërprerë." [El-Furkan 63-77]

Argumentet nga Sunneti

Transmeton Buhariu në sahihun e tij nga ebu Hurejra r.a. se i Dërguari, salallahu alejhi we selem, ka thënë: "Allahu shtatë njerëz do ti fus nën hijen e Tij, në ditën kur nuk do të ketë hije përveç hijes së Tij:

- Udhëheqësin e drejtë, - Të riun që është rritur në adhurim Allahut s.v.t,
- Njeriun që zemra e tij është e lidhur me xhamit,
- Dy njerëz që janë dashur për hire të Allahut, janë bashkuar dhe janë ndarë për Atë.
- Njeriun që e ka thirr një grua e bukur me pozit, dhe ai i është përgjigjur unë i frikohem Allahut,
- Njeriu që ka dhënë lëmoshë fshehtas, mos të dijë dora e tij e majtë, atë që jep dora e djathtë, dhe
- Njeriu që ka kujtuar Allahun në vetmi, e sytë i kanë lotuar."

[Transmeton Buhariu nr.660 dhe Muslimi nr.2380]

Pejgamberi, salallahu alejhi we selem, gjithashtu ka thënë:

"Kush dashuron për hire të Allahut, urren për hire të Allahut, jep [lëmoshë] për hire të Allahut dhe nuk jep për hire të Allahut, ai e ka plotësuar imanin]."

[Transmeton Ebi Davudi nr.4681]

Të gjitha argumentet që kemi përmendur janë si ilustrim, përndryshe argumentet janë të shumta në të cilat mbështetet Ehli Suneti.

Sheikhul Islam Ibn Tejmije thotë: ".Kur thonë [Selefi] se imani është fjalë dhe veprë, kanë për qëllim fjalën e zemrës, fjalën e gjuhës, veprën e zemrës dhe veprën e gjymtyrëve." [Mexhmu el-Fetava, 7/171]

- Imani shtohet dhe pakësohet

Shtohet me vepra të mira dhe pakësohet, me vepra të këqija.

Argumentet nga Kur'ani

Allahu Te'ala thotë: "Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë për ta shtuar ata imanin me imanin e vet që kishin..." [El-Fet'h, 4]

Allahu Te'ala thotë: "...Ne atyre edhe më ua shtuam udhëzimin." [El-Kehf, 13]

Allahu Te'ala thotë: "E All-llahu u shton besimi atyre që u udhëzuan..." [Merjem, 76]

Allahu Te'ala thotë: "Kurse ata që e gjetën rrugën e drejtë, Ai atyre ua shton edhe më udhëzimin në rrugën e drejtë dhe u ofron mundësi të jenë edhe me të matur." [Muhammed, 17]

Allahu Te'ala thotë: "E kur zbret ndonjë kaptinë, ka prej tyre që thonë: "Cilit prej jush ia shtoi kjo imanin?" Sa u përket atyre që besuan, atyre u shtohet imani dhe gëzohen për të." [Teube, 124]

Allahu Te'ala thotë: "E atyre [shokëve të pejgamberit] që dikush u tha : "Populli (idhujtarët) janë tubuar t'ju sulmojë, pra kini frikë!" Ajo, vetëm ua shtoi edhe më shumë imanin e thanë: "Neve na mjafton që kemi All-llahun, Ai është mbrojtësi më i mirë!" [Ali Imran, 173]

Nga argumentet që sjellin dijetarët e ehli sunetit se imani shtohet dhe pakësohet, janë edhe ajetet që tregojnë se njerëzit dallojnë në iman, me gradat e tyre në këtë botë dhe në botën tjetër.

Allahu Te'ala thotë: "Nuk janë të barabartë prej besimtarëve ata që ndejtën (nuk luftuan) dhe ata që me pasurinë dhe me jetën e tyre luftuan në rrugën e All-llahut, me përjashtim të atyre që ishin të penguar pa vullnetin e vet. Ata që luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre, All-llahu i gradoi në një shkallë më të lartë mbi ata që ndejtën (me arsye) Por të gjithëve All-llahu u premtoi shpërblim, ndërsa ata që ndejtën (pa arsye) All-llahu gradoi luftëtarët me një shpërblim të madh. Vende të larta me falje gabimesh e mëshirë nga Ai. All-llahu është që falë shumë dhe mëshiron." [En-Nisa, 95-96]

Allahu Te'ala thotë: "E, ç'keni ju që nuk jepni për rrugën e All-llahut, kur dihet se All-llahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka? Nuk janë të barabartë prej jush ata që dhanë nga pasuria e tyre dhe luftuan para çlirimit, sepse të tillët kanë vlerë të madhe nga ata që dhanë dhe luftuan pas. Por të gjithëve All-llahu u premtoi të mirat; All-llahu di çka punoni." [El-Hadid, 10]

Allahu Te'ala duke na treguar se si dallojnë besimtarët në ditën e kijametit me gradat e tyre thotë: "Të tillët janë besimtarë të vërtetë dhe për këtë kanë vende të larta te Zoti i tyre, kanë falje dhe kanë furnizim në mënyrë të ndershme." [El-Enfal, 4]

Allahu Te'ala thotë: "Shiko se si Ne i kemi dalluar disa prej tjerëve, po dallimi në botën tjetër është më i madh dhe është përparësi më e madhe." [El-Isra, 21]

Argumentet nga Sunneti

Transmeton Enes ibn Maliku r.a. se i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Do të dale nga zjarri ai që thotë nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut, dhe në zemrën e tij ka iman sa pesha e një kokrrë misri. Do të dale nga zjarri kush thotë nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut dhe në zemrën e tij ka iman sa pesha e një kokrrë gruri. Do të dal nga zjarri kush thotë nuk

ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe në zemrën e tij ka iman sa pesha e thërmisë." [Transmeton: Buhariu, 44 dhe Musimi, 478]

Transmeton Ebu Umamete el-Bahilij r.a. se i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "**Kush dashuron për hire të Allahut, urren për hire të Allahut, shpenzon për hir të Allahut dhe nuk shpenzon për hir të Allahut, ka plotësuar imanin.**"

Transmeton Ebu Seid el-Hidrij r.a. se i Dërguari, salallahu alejhi ve selem ka thenë: "**Kush nga ju, sheh ndonjë të keqe le ta largojë me dorë, nëse nuk mundet atëherë le ta mohoj me gjuhë, e nëse nuk mundet atëherë me zemër dhe ky është imani më i dobët.**" [Transmeton: Muslimi, 177]

Fjala e Pejgamberit salallahu alejhi ve selem, drejtuar Handheles r.a. "Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, sikur të vazhdonit të jeni në atë gjendje në të cilën jeni me mua, do tu kishin përshëndetur melekët në ndejat dhe rrugët tuaja. Mirëpo, o Handhele, momente dhe momente (e përsëriti tre herë)." [Transmeton: Muslimi, 6966]

- **Konsesusi i selefit dhe fjalët tyre se Imani shtohet dhe pakësohet**

Hafidh ibn Rexhebi në "Fet-hul barij" duke shtuar mbi fjalët e Buhariut thotë: "Shumica e dijetarëve kanë thënë se imani shtohet dhe pakësohet.

Kjo transmetohet nga një palë e sahabëve siç është **Ebu Derda Ebu Hurejra Ibn Abasi**, dhe të tjerë. Me atë kuptim transmetohet edhe nga **Aliu r.a** dhe **Ibn Mes'udi r.a** – Allahu qoftë i kënaqur me ata – gjithashtu transmetohet edhe nga **Muxhahidi** dhe **tabiinët** tjerë." [Fet-hu el-Barij, 1/7]

Transmetohet nga **Ebu Derda r.a** se ka thënë: "**Imani shtohet dhe pakësohet.**" [Sunen ibn Maxhe 1/75, Sherh Uslul I'tikad el-Lalikai, 5/1015]

Transmetohet nga **Ebu Hurejra r.a** se ka thënë: "**Imani shtohet dhe pakësohet.**" [El-Suneh li-Abdilah, 1/314, el-Ibane li-Ibn Bata, 2/844]

Shejhul el-Islam Ibn Tejmije thotë: "**Selefi (të parët e mirë të muslimanve) janë pëlqyer se imani është fjalë dhe vepër, shtohet dhe pakësohet.**" [Mexhmu el-Fetava, 7/672]

Ibn Kethiri thotë: "**Imam Shafiu, Ahmedi ibn Hanbel, Ebu Ubejde dhe të tjerë kanë përcjellur konsensusin se imani është fjalë dhe vepër shtohet dhe pakësohet.**" [Tefsir ibn Kethir, 1/72]

Transmetohet nga **Muxhahid ibn Xhebr** se ka thenë: "**Imani shtohet dhe pakësohet.**" [El-Suneh li-Abdilah, 1/31, el-Ibane, 2/859]

Urvetu ibn Zubjer thotë: "**Nuk pakësohet besnikëria te njeriu vetëm se pakësohet imani i tij.**" [El-Iman li-Ibn Shejbe, 56]

El-Evzaiu thotë: "Imani është fjalë dhe vepër shtohet dhe pakësohet, kush pretendon se imani shtohet dhe nuk pakësohet keni kujdes nga ai se është bidatgj." [El-Lalikai, 5/1030]

Kur është pyetur Evzaiu për shtimin e imanit është përgjigjur: "Po, derisa bëhet si kodrat,"- i thanë: "a pakësohet?" Tha: "Po, derisa nuk mbetet asgjë nga ai." [El-Lalikai, 5/1030]

Sufjan ibn Ujejne thotë: "Imani është fjalë, vepër dhe nijet, shtohet dhe pakësohet. Shtohet me ibadet dhe pakësohet me mëkate." [El-Lalikai, 1/170]

Ahmed ibn Hanbeli thotë: "Imani është fjalë dhe vepër shtohet dhe pakësohet ashtu si ka ardhur në hadith "Imanin më të plotë nga besimtarët e ka ai që ka sjelljen më të mirë." [El-Lalikai, 1/179]

Ali el-Medinij thotë: "Imani shtohet dhe pakësohet. Imanin më të plotë nga besimtarët e ka ai që ka sjelljen më të mirë." [El-Lalikai, 1/187]

Ebu Zur'ah el-Razij dhe Ebu Hatim el-Razij thonë: "Të gjithë që i kemi arritur në Hixhaz, Irak, Sham, dhe Jemen, medhhebi i tyre ishte se imani është fjalë dhe vepër shtohet dhe pakësohet." [Eslu el-Suneh ve I'tikadu el-Dini li-Ebi hatim el-Razij]

Transmetohet nga Buhariu me zinxhirë të saktë se ka thënë: "Kam takuar me tepër se njëmijë dijetarë nga vende të ndryshme asnjë nuk kundërshtonte se imani është fjalë dhe vepër, shtohet dhe pakësohet."

- Imani pjesëzohet

Nga rregullat e **Ehli Sunetit** në çështjen e imanit është se, imani pjesëzohet dhe se, është i përbërë nga pjesë. Këtë rregull dijetarët e Ehli Sunetit e kanë marrë nga argumentet e shumta në Kur'an dhe Sunnet.

Argumente nga Kur'ani dhe Sunneti

Allahu Te'ala thotë: "Nuk është tërë e mira (e kufizuar) të ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, lajmëtarëve dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmeve, bonjakëve, të vërfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim të robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit." [El-Bekare, 177]

Ky është nga ajetet që më së shumti ka përmbledhur nga degët e imanit, andaj Allahu s.v.t më në fund dëshmon se këta njerëz janë besnik dhe të devotshëm. Thotë: "Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët, ata të cilët janë të përvuilur dhe janë të kujdesshëm gjatë faljes së namazit, dhe ata të cilët i shmangën të kotës (fjalë a punë), dhe ata të cilët rregullisht japin zeqatin, dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime), me përjashtim ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre (robreshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuara, e kush kërkon përtej tyre (dëfrim nga të ndaluarat), të tillët janë ata që e kanë shkelë normat e caktuara, dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë, dhe ata të cilët i kushtojnë kujdes kohës së namazit të tyre." [El-Mu'minun, 1-9]

Gjithashtu Allahu Te'ala thotë: "Është e vërtetë se njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm. Pse kur e godit ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi.

Ndërkaq, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprac. Përveç atyre që falen, të cilët janë të rregullt në faljen e namazit të tyre. Dhe ata që në pasurinë e vet kanë ndarë në një pjesë të caktuar. Për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp. Edhe ata që e besojnë bindshëm ditën e gjykimit. Edhe ata që i frikësohen dënimit nga Zoti i tyre. Sepse është e vërtetë që nuk ka shpëtim prej dënimit nga Zoti i tyre. Edhe ata që janë ruajtur prej punëve të ndyra (amurale). Me përjashtim ndaj grave të veta dhe ndaj robërshave që i kanë në posedim, ata nuk qortohen për to. E kush kërkon përveç tyre, të tillët janë të shfrenuar (meritojnë dënim). Edhe ata që janë besnikë ndaj amanetit që u është besuar dhe ndaj premtimit të dhënë. Edhe ata që dëshminë e vet e zbatojnë (nuk e mohojnë, nuk e fshehin). Edhe ata që janë të kujdesshëm ndaj rregullave të namazit të tyre." [El-Me'arixh, 19-34]

Gjithashtu thotë: "(Të Xhenetit janë) Edhe ata që pendohen, ata që sinqerisht adhurojnë, ata që falenderojnë, ata që agjërojnë, ata që bëjnë ruku, që bëjnë sexhde, që urdhërojnë për të mira e ndalojnë nga të këqijat, edhe përmbushin dispozitat e All-llahut. Pra, përgëzoj besimtarët." [Teube, 112]

Në këtë ajet, Allahu përmend veti të besimtari, e që janë nga degët e imanit. Kur'ani është i mbushur përplot ajete që përmbledhin veprat e imanit, mirëpo ne këtu kemi përmendur vetëm disa ajete si ilustrim.

Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejra r.a. se i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Imani është shtatëdhjetë e disa pjesë ose gjashtëdhjetë e disa pjesë. Më e larta fjala la ilahe il-lallah, më e ulëta largimi i pengesës nga rruga, dhe turpi është një degë nga imani." [Transmeton; Buhariu, 9 dhe Muslimi, 153]

Meriton të përmendim se disa prej degëve të imanit janë nga vepra e zemrës, e disa janë nga fjalët e gjuhës, e disa janë që kryhen me gjymtyrë siç e

shpjegon këtë hadithi që kemi përmendur, ku fjala la ilahe il-lallah kryhet me gjuhë, largimi i pengesës me gjymtyrë, dhe turpi është nga veprat e zemrës.

Dijetarët musliman kanë dhënë kontribut të madh në përmbledhjen e degëve të imanit duke shkruar libra vëllimor.

Libri më i njohuri është "Shuabu el-Iman" i dijetarit të madh Hafidh el-Bejhekij.

• Çfare e prish Imanin (Besimin)

Imanin e prish dhe e rrënon **Kufri**.

Fillimisht te definojm çfarë do të thotë fjala **Kufër**, në gjuhën arabe ka kuptimin e mbylljes dhe mbulimit, kurse në terminologjinë Islame, kufri është e kundërta e imanit. Kufri është mosbesimi në All-llahun xh.sh. dhe pejgamberët e Tij, pa marrë parasysh përgënjeshttrimin apo mospërgënjeshttrimin e tyre, por mjafton vetëm egzistimi i dyshimit, kundërshtimit, zilisë, mendjemadhësisë ose pasimi i dëshirave të cilat pengojnë nga pasimi i shpalljes, edhe pse përgënjeshtrimi është kufri më i madh. I ngjajshëm është edhe ai që përgënjeshton ata nga zilia duke qenë i bindur se ata janë të vërtetë.

Kufri ndahet në dy lloje:

Kufri i madh, i cili largon nga umeti Islam,dhe ndahet në 5 lloje:

1.Kufri i përgënjeshttrimit, argument është fjala e All-llahut xh.sh.:

“ Kush është më mizor se sa ai që shpif gënjeshtër ndaj All-llahut ose përgënjeshton hakkun kur ai erdhi? A nuk mjafton xhehennemi vendqëndrim për pabesimtarët”. [El-ankebut-68]

2.Kufri i refuzimit dhe mendjemadhësisë. All-llahu xh.s. thotë:

“Përkujto kur Ne u thamë meleqëve. Bëni sexhde Ademit. Të gjithë i bënë sexhde përveç Iblisit, ai refuzoi, bëri mendjemadhësi dhe u bë nga pabesimtarët.” [El-bekare-34.]

3.Kufri i dyshimit. All-llahu xh.sh. thotë:

“ Dhe ai hyri në kopshtin e vet, por duke qenë dëmtues i vetes tha: Unë nuk mendoj se do të zhduket ky (kopsht imi) ndonjëherë.`Dhe nuk besoi se do të ndodhë kijameti, por nëse bëhet që të kthehem te Zoti im, pa dyshim do të gjej ardhmëri edhe më të mirë se kjo. Shoku i vet i tha atij duke polemizuar: `A e

mohove Atë që të krijoj ty nga dheu, pastaj nga një pikë uji, pastaj të bëri njeri të plotë”. [El-kehf-35-37]

4.Kufri i refuzimit: All-llahu xh.sh. thotë: “ Ata të cilët mohuan, refuzojnë qortimet tona.” [El-ahkaf-3]

5.Kufri i nifakut: All-llahu xh.sh. thotë: “Kjo për arsye se ata besuan, e pastaj mohuan, kështu që Ne ua vulosëm zemrat e tyre dhe ata nuk kuptojnë”. [El-munafikun-3]

Lloji i dytë është kufri i vogël që nuk të largon nga umeti Islam. Ai është kufri veprues, e që janë gjynahet që në Kur'an dhe në Sunnet janë quajtur kufr, por që nuk kanë aritur shkallën e kufrit të madh, sikurse është p.sh. mohimi i begative të All-llahut xh.sh. i përmendur në fjalën e All-llahut xh.sh. “ All-llahu sjell si shembull një fshat që ishte i sigurt dhe i qetë, të cilit i vinte furnizimi nga të gjitha anët me bollëk, kurse ata (banorët) i përbuzën të mirat e All-llahut”. [En-nahl- 112]

Në të njëjtën shkallë është edhe lufta kundër muslimanit e përmendur në fjalën e Pejgamberit s.a.v.s. “ Sharrja e muslimanit është mosrespektim i All-llahut, ndërsa të luftosh kundër tij është kufr”, dhe fjala e tij: “Mos u ktheni pas meje pabesimtarë, e t'i mëshoni njëri tjetrit me shpata”. Gjithashtu betimi në dikë përveç All-llahut xh.sh. është në të njëjtën shkallë, sepse Muhamedi s.a.v.s. tha: “ Ai që betohet në diç tjetër përveç All-llahut xh.sh. ka bërë kufr”. All-llahu xh.sh. e quajti vepruesin e mëkatit të madh besimtarë. Ai tha: “ O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi për dënim për mbytje...” [El-bekare: 178]

Vrasësin All-llahu xh.sh. nuk e nxorri nga ata që besuan dhe bëri vëlla të përgjegjësit për hakmarje në vrasje, e tha: **“ Kurse atij që i falet diçka nga vëllau i vet atëherë ajo le të përcillet kuptueshëm...”** [El-bekare: 178]

Këtu padyshim, është për qëllim vëllazëria e fesë. All-llahu xh.sh. thotë: **“ Nëse dy grupe në mesin e besimtarëve luftojnë ndërmjet vete, pajtoni ju ato...”** deri tek fjala **” Vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtoni vëllezërit tuaj mes veti...”** [El-huxhurat: 9, 10]

Dallimi ndërmjet kufrit të madh dhe të vogël është: kufri i madh largon nga umeti islam dhe i shkatëron veprat e mira, kufri i vogël nuk largon nga umeti islam dhe nuk i shkatëron veprat e mira, por i pakëson ato dhe ate sipas madhësisë së tij dhe vepruesi i tij i nënshtrohet qortimit.

Kufri i madh e shpie njeriun në zjarr përgjithmonë kurse vepruesi i kufrit të vogël nëse hyn në Xhehenem, nuk qëndron aty përgjithmonë. Gjithashtu All-llahu xh.sh. mund t'ia falë atij, kështu që nuk hyn fare në zjarr. Kufri i madh lejon gjakun dhe pasurinë, kurse kufri i vogël nuk i lejon ato. Kufri i madh detyron armiqësinë e sinqertë mes vepruesit të tij dhe besimtarëve. Nuk i lejohet besimtarëve ta duan dhe shoqërojnë ate edhe nëse është njeriu më i afërmi i tij. Kurse kufri i vogël nuk e pengon dashurinë, por vepruesin e tij duhet dashur dhe shoqëruar sipas masës së imanit të tij dhe urrehet e armiqësohet sipas masës së mosrespektimi të tij ndaj All-llahut xh.sh.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë:

“Të përmendurit e begative të All-llahut është shenjë falenderimi, e mospërmendja është shenjë kufri. Kush se falenderon për të paktën, nuk falenderon as për të shumtën. Kush nuk i falenderon njerëzit, nuk e falenderon as All-llahun . Uniteti është mëshirë, e përçarja dënim.”

[Transmeton: Bejhakiu]

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë:

“Ndërmjet Mu`minit dhe kufrit qëndron lënia e namazit. (Kush e lë namazin, ai nuk është larg besimit, kurse namazi është mburojë që e mbron nga ato).”

[Transmeton: Xhabiri]

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë:

“Mos e ktheni kryet nga prindërit tuaj, sepse kush vepron ashtu, ka bërë kufër”. [Transmeton: Buhariu]

- **Kaptina e tretë:** Ibadeti (Adhurimi) me llojet e saja, dhe çfarë e prishë atë.

Fillimisht desha të definoj ç'farë do të thotë Ibadet (Adhurim).

Ka thënë Shejh Islam Ibn Tejmije:

Adhurim apo (Ibadet) do të thotë: "Është emër i përgjithshëm për çdo gjë që donë All-llahu subhanehu ue te 'ala, dhe është i kënaqur nga thënjet, shprehjet, punët apo vepërat të dukshme apo të padukshme, e jashtme apo e mbrendëshme".

Hyn gjithashtu në përkufizimin e ibadetit çdo gjë që e ka ligjësuar Allahu në Librin e Tij apo në Sunnetin e të Dërguarit të Tij Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Bëjnë pjesë këtu adhurimet e llojllojshme.

Ka prej tyre adhurime të zemrës siç janë gjashtë kushtet e imanit, frika, shpresa, mbështetja, shpresa në mëshirë, frika nga ndëshkimi e ibadete tjera. Ka prej tyre edhe adhurime të dukshme siç janë namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi.

Ibadeti (adhurimi) nuk është i vlefshëm derisa të ndërtohet në dy themele.

I pari. është sinqeriteti në adhurimin e Allahut dhe mosshoqërimi i dikujt tjetër në adhurim, e ky është kuptimi i dëshmisë **La ilahe illall-llah** (Nuk meriton kush adhurim pos Allahut).

Thotë i Lartësuari: **"Vini re! Adhurim i sinqertë është vetëm ai për Allahun! Ndërsa ata që në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë (duke thënë): Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër Allahut, s'ka dyshim se Allahu do të gjykojë mes tyre për atë që ata ishin në kundërshtim. E, është e vërtetë se Allahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë, atë që është rrenacak, jobesimtar ". [Ez-Zumer: 3]**

Gjithashtu Allahu ka thënë: **" Ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij..."[El-Bejjineh: 5]**

I dyti: është pasimi i asaj me të cilën ka ardhë i Dërguari i Allahu sal- lall-llahu alejhi ve sel-lem. Pra, që të veprojë rob i atë që e ka vepruar i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në mënyrën se si e veproi ai pa ndonjë shtesë e

as mangësi. E ky është kuptimi i, dëshmisë **Muhammedun resulull-llah** (Nuk meriton kush passim pos Muhammedit të Dërguarit të Zotit).

Thotë Allahu i Lartësuar: " **Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu të ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja ...**" [Ali-Imran: 31]

Gjithashtu ka thënë: "... **Çka t'ju jep Pejgamberi, atë merrnie e çka t'ju ndalojë, përmbanju ...**" [El-Hashr: 7]

Gjithashtu thotë: "Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden **singerisht**". [En-Nisa': 65]

Të adhuruarit e plotë nuk realizohet pa këto dy çështje.

E para: Përsosmëria e dashurisë ndaj Allahut, ashtuqë robi i jep përparësi dashurisë ndaj Allahut dhe dashurisë ndaj atyre që i don Allahu, para dashurisë ndaj çdo gjëje tjetër.

E dyta: Përsosmëria e nënshtrueshmërisë dhe e përluljes ndaj Allahut, ashtuqë robi ti nënshtrohet Allahut duke i kryer urdhërat e Tij dhe duke u larguar nga ato që i ka ndaluar Ai. Pra, të adhuruarit është shprehje që përmbledh përsosshmërinë e dashurisë dhe përsosshmërinë e nënshtrimit, përluljes, shpresës dhe frikës.

Me këtë realizohet të adhuruarit e robit ndaj Zotit dhe Krijuesit të Tij.

Duke e adhuruar Allahun robi arrin të dashuria e Allahut dhe kënaqësia e Tij. Allahu dëshiron që robi i Tij t'i afrohet me ato që ia bëri obligim.

E sa më shumë që robi i shton ibadetet vullnetare (nafilet), shtohet afria e tij ndaj Allahut subhanehu ue te'ala dhe ngritet shkalla e tij tek Allahu. Kjo bëhet shkak prej shkaqeve të hyrjes në Xhennet me mirësinë e Allahut dhe me mëshirën e Tij.

Thotë Allahu subhanehu ue te'ala: **"Lutnie Zotin tuaj të përulur e në heshtje, pse Ai nuk i do ata që e teprojnë "**. [El-A'raf: 55]

Allahu i Lartësuar na ka krijuar për ta adhuruar Atë dhe mos t'i shoqërojmë Atij askënd.

Allahu i Lartësuar thotë: **"Unë nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit vetëm se për të më adhuruar Mua"**. [Edh-Dharijat: 56]

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) thotë: **"E drejta e Allahut mbi njerëzit është që ta Adhurojnë vetëm Atë dhe mos t'i shoqërojnë Atij shok"**.

Ashtu si na ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij; me sinqeritet dhe sipas sunetit. Allahu i Lartësuar thotë: **"Dhe nuk ishin të urdhëruar për tjetër vetëm se për të adhuruar Allahun me sinqeritet"**. [El-Bejjineh: 5]

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) thotë: **"Kush punon një vepër e cila nuk është sipas punës sonë, ajo është e kthyer mbrapsht (nuk pranohet)"**

Duke adhuruar Allahun e Lartësuar me frikë nga Zjarri i Tij, me shpresë për Xhenetin e Tij dhe dashuri për Të.

Allahu i Lartësuar thotë: **"Dhe luteni Atë me frikë e shpresë"** [Frikë prej Zjarrit të Tij dhe duke shpresuar Xhenetin e Tij". [El-A'raf: 56]

Gjithashtu thotë: **"Atëherë Allahu do të bjerë një popull të cilin e do dhe ata e duan Atë"**. [El-Maide: 54]

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) thotë: **"I lutem Allahut për Xhenetin dhe kërkoj mbrojtje prej Tij nga Zjarri"**.

Adhurimi është qëllimi më i madh i nënshtrimit dhe përfundon me dashurinë ndaj Allahut, ekzistenca e krijuesit mbështet në adhurimin e Tij, sunduesi në

renditjen dhe sjelljen e çdo sendi. Dhe për këtë e kemi marrë si Zot adhurues. Thënia (Allah) treguesi i cilësisë së Atij i Lartësuar, dhe ajo është hyjnore përmbledhëse të kuptimeve të emrave të bukur dhe cilësive të larta e të plota, dhe ai i cili ndaloi politeistet me njohjen se është Zot, krijues furnizues e tek i cili nuk ka kthim tjetër kund përveç se tek Ai.

Dhe kuptimi: **Allah**–Adhurimet që zemra dhe nështrimi i takon vetëm Atij.

- Çfarë e prish Ibadetin apo (adhurimin)

Rregull. “Për tu pranuar një vepër tek Allahu xh.sh duhet patjetër të plotsohen dy kushte e ato janë:

1-Sinqeriteti dhe

2-Të jetë në përputhshmëri me sunnetin e Pejgamberit alejhi selam.

Ndërsa veprën apo ibadetin tënd e prish dhe rrënon një component të cilën e quajmë, “Er-Rija’u” d.m.th. – Syefaqësia.

Për **Syefaqësinë** ka thënë: Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thotë: **“Gjëja që frikësohem më shumë për ju është shirku i vogël”. Thanë: “O i dërguari i Allahut, e çfarë është shirku i vogël”. Ai tha: “Syefaqësia”.**

Nëse shirku i vogël ka qenë rrezik për sahabët të cilët jetonin me Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem, dhe përjetuan zbritjen e Kur’anit e për të tjerët edhe më shumë e posaçërisht ata që kanë pak dituri dhe kanë besim të dobët.

Muslimani nuk do të mbrohet prej shirkut me asgjë tjetër pos me sinqeritet ndaj Allahut dhe përcjellje të përpiktë të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem.

Kur **Ibën Kajimi**, Allahu e mëshiroftë, ka përmendur shirkun e adhuruesve të diellit, hënës dhe adhuruesve të zjarrit, ka thënë: “Shirku në adhurim është më i lehtë se ky shirku, ngase e vepron ai i cili beson se nuk meriton adhurim dikush tjetër përveç Allahut dhe se nuk sjell dëm e as dobi, nuk jep dhe nuk merr vetëm se Allahu, nuk ka Zot tjetër krahas Allahut, por nuk e veçon dhe njëson në veprat e tij, gjithashtu edhe gjatë adhurimit. Porse ndonjëherë vepron për interesat personale, ndonjëherë për mirësitë e kësaj bote apo për të kërkuar pozitë, lëvdata tek krijesat. Gjatë adhurimit dhe veprimit të veprave, Allahu ka pjesë ashtu siç ka epshi, egoja e tij, shejtani ka pjesë, krijesat kanë pjesë e kështu është gjendja e shumicës së njerëzve, ky është shirku për të cilin ka thënë Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem: “Shirku në këtë umet është më i fshehtë se zvarritja e mizës përdhese”. Thanë: “Si të shpëtojme, o i dërguari i Allahut?”. Tha: “Thuaj O Zot Kërkoj mbrojtje prej Teje që mos të veproj shirk duke ditur e kërkoj falje për atë që nuk e di”.

Ashtu siç është Allahu një dhe nuk ka Zot tjetër, gjithashtu duhet të jetë adhurimi vetëm për Allahun. Ashtu siç është i veçuar me uluhijetin e Tij, duhet të veçohet me adhurim. Vepra e mirë është ajo vepër e cila nuk posedon syfaqësi dhe është sipas Sunetit. Prej lutjes së **Omer ibën Hatabit**, radijallahu anhu, ka qenë: “O Zot bëre (shndërroje) veprën time gjithë të mirë dhe bëre të sinqertë për fytyrën Tënde dhe mos i bën pjesë askujt”.

Ky shirk në adhurim e asgjëson shpërblimin e veprës, ndoshta do të dënohet për syfaqësinë nëse vepra është obligim, ngase e degradon në shkallën e mosvepruesit, dënohet për lënien e urdhërit ngase Allahu, subhanehu ve teala, ka urdhëruar që të adhurohet me sinqeritet.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: **“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë”**. [Bejine: 5]

Ai i cili nuk e adhuron Allahun, subhanehu ve teala, me sinqeritet, nuk vepron me atë çka është urdhëruar, por atë çka e vepron është vepër e papëlqyer (jo e urdhëruar), atëherë ajo vepër nuk është e vërtetë dhe nuk pranohet.

Allahu, subhanehu ve teala, në hadith kudsij thotë: “Unë jam më i pasur prej ortakëve nga shirku kush vepron një vepër dhe më bën ortak me dikë tjetër, kjo vepër është për atë e Unë jam i distancuar nga kjo vepër”.

Ky lloj i shirkut ndahet në dy lloje: falës dhe jo falës.

1. Të jetë tërësisht syfaqësi, nuk dëshiron personi me veprën e tij vetëm se të mirat e kësaj bote, apo bën syfaqësi (shtirje) për krijesat si hipokritët (munafikët) për të cilët Allahu, subhanehu ve teala, tha:

“Munafikët përpiqen të mashtrojnë Allahun (duke u paraqitur rrejshëm si besimtarë), por Allahu mbizotëron dinakëritë e tyre. Ata edhe kur falen, falen me përtaci dhe vetëm sa për t’u dukur te njerëzit dhe fare pak e përmendin

Allahun". [Nisa: 142]

Për këtë vepër nuk dyshon muslimani se është asgjësuar (e prishur) dhe se vepruesi meriton hidhërim prej Allahut, subhanehu ve teala.

2. Gjendja e dytë të jetë vepra për Allahun, subhanehu ve teala, e (duke) shoqërua me syfaqësi, ky lloj ndahet në dy lloje:

A) Ta shoqëron syfaqësia prej fillimit të veprës.

b) Gjatë kryerjes së adhurimit ta shoqëron apo e godet syfaqësia.

Për sa i përket gjendjes së parë vepra e tij nuk pranohet dhe është asgjësuar.

Kjo argumentohet me hadithin të cilin e transmeton Muslimi nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, i cili ka thënë: **"Tha Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, se Allahu, subhanehu ve teala, ka thënë: 'Unë jam më i pasur prej ortakëve nga shirku kush vepron një vepër dhe më bën ortak me dikë tjetër, kjo vepër është për atë e Unë jam i distancuar nga kjo vepër'".**

E nëse e godet syfaqësia dhe vazhdon gjatë adhurimit, disa dijetarë thonë se asgjësohet vepra (e bën të kotë veprën) e të tjerët thonë nëse vazhdon me të, aq sa posedon sineritet, do të shpërblehet dhe do të dënohet për syfaqësinë.

Nëse mundohet ta largon ky ka pjesë nga fjala e Allahut, subhanehu ve teala: **"S'ka dyshim se Allahu nuk bën pa drejtë as sa grimca, e nëse ajo vepër është e mirë, Ai e shumëfishon atë dhe Vetë Ai i jep shpërblim të madh. Dhe si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull, e ty do të sjellim dëshmitarë mbi ata (që nuk të besuan)?"** [Naziat: 40-41]

Ibn Kajimi, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij **"Ialam el Muvakinë"** thotë:

"Ky është sikur ai i cili falet me pare. Falet, por falet për Allahun dhe rrogën.

Dhe sikur ai i cili bën Haxh që ta kryej obligimin dhe t'i thuhet se ai është 'Haxhi', apo jep zekat e kështu me radhë. Këtij nuk i pranohet vepra".

Ibën Rexhebi, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Me këtë i zvogëlohet, pakësohet shpërblimi i xhihadit, por nuk asgjësohet tërësisht".

Po ashtu, Allahu e mëshiroftë, thotë "I kemi cekur më parë hadithet e xhihadit

të cilët aludojnë se ai i cili dëshiron përmes luftës në rrugën e Allahut diçka nga të mirat e kësaj bote, nuk ka shpërblim!".

Këto hadithe aludojnë se ky person nuk ka patur qëllim tjetër nga xhihadi i tij vetëm se të mirat e kësaj bote. Nga kjo kuptojmë se ka dallim mes atij i cili lufton për përmendje dhe sevape dhe mes atij i cili lufton për plaçka të luftës dhe shpërblim. Për të parin transmetohet prej Ebu Umames tek Nesaiu me zinxhir të mirë se një njeri erdhi tek Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, dhe e pyeti nëse një njeri lufton duke kërkuar shpërblim dhe autoritet (pozitë, përmendje), si është çështja me të? Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, iu përgjigj: "Nuk ka asgjë për të". Këtë pyetje e përsëriti tre here, ndërsa Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, përgjigjej: "Nuk ka asgjë për të", pastaj tha: "Allahu, subhanehu ve teala, nuk pranon vepër vetëm nëse është i sinqertë dhe ka për qëllim fytyrën e Allahut, subhanehu ve teala", kurse për të dytin e cekëm më herët Allahu është më i dituri.

E Lus Allahun Subhanehu ue te'ala që të e pranoj këtë vepër nga unë, dhe ta bëjë argument ndaj meje ditën e gjykimit e jo kundër meje, dhe të më fal mua dhe prindërit e mi, dhe ata që më mësuuan mua, dhe ata të cilëve kanë hak ndaj meje, e thënia e fundit është falënderimi i takon Allahut subhanehu ue te'ala.

Mblodhi dhe përshtati,

Faik ASANI

Recenzues fetarë:

Jusuf Hajrullahi

Më date: 05.09.2011

Literatura e shfrytëzuar:

1. “Kitabu-Teuhid” – Nga Shejh Muhamed Ibn Abdul-Uehab.
2. “Usulu-El-Erbea’” – Nga Shejh Muhamed Ibn Abdul-Uehab.
3. “Mexhmu'ul-Fetaua” – Nga Shejh Islam Ibn Tejmije.
4. “El-Iktida” – Nga Shejh Islam Ibn Tejmije.
5. “Tefsir Kur'anil-Adhim” – Nga Shejh Ibn Kethir dhe “Tefsiri i Imam Kurtubiut”.
6. “Ma'rixhul-Kabul” – Nga Shejh Hafidh El-Hakemi.
7. “Kauaidu fi bejani Hakikatul-Iman Inde Ehli-Sunne uel-Xhema'.”
–Nga Shejh Adil bin Muhamed bin Ali Shejhanij.
8. “Ia’lam el Muvakiinë” – Nga Shejh Islam Ibn Kajimi.
9. “Shua’bul- El-Iman” – Nga Imam Hafidh el-Bejhakij
10. “Kur'ani-Kerim” – Në shqip me përkthim nga Sherif Ahmeti Etj...

www.thirrjaislame.com